



19



Albania
Investment
Council

Improving Transparency and Investment Climate

Inovacioni në Sipërmarrje, si një Sfidë për Rritjen e Konkurrueshmërisë dhe Nxitës i Rritjes Ekonomike

Tiranë, Mars 2021

Ky dokument pune është përgatitur në kuadër të mbledhjes XXII të Këshillit të Investimeve (10 nëntor 2020) nga ekspertët e Sekretariatit të Këshillit të Investimeve z. Elvis Zerva, ekspert ligjor dhe rregullator, znj. Elida Fara, eksperte për ekonominë, znj. Xaira Shurdha, eksperte për monitorimin dhe ndërlidhjen, nën drejtimin e Drejtores së Sekretariatit, znj. Diana Leka (Angoni). Mbështeti në organizimin e takimeve dhe mbledhjeve me partnerë, si dhe në redaktimin gjuhësor të materialit znj. Elisa Lula, oficere administrative dhe komunikimit pranë Sekretariatit. Një falenderim i veçantë për administratorët e subjekteve private, shoqatat e biznesit, institucionet shtetërore (Ministria e Arsimit, Agjencia e Kërkimit Shkencor, Ministria e Financës dhe Ekonomisë, etj.), ekspertët dhe universitetet (Marin Barleti, Luarasi, UT-Fakulteti i Ekonomisë), projektet donatore (GIZ-Proseed) që bashkëpunuan me Sekretariatin në kuadrin e përgatitjes së këtij materialit me informacion sa më të përditësuar.



LISTA E SHKURTIMEVE

AIDA	Agjencia Shqiptare për Zhvillimin e Investimeve
AKKSHI	Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit
AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
ALL	Monedha Lek
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
BERZH	Banka Evropiane për Zhvillimin dhe Rindërtim
BP	Ballkani Perëndimor
ECD	Delegacioni i Komisionit Evropian
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
GII	Indeksi Global i Inovacionit
IHD	Investime të Huaja Direkte
INSTAT	Instituti i Statistikave
KI	Këshilli i Investimeve
MASR	Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë
MFE	Ministria e Financës dhe Ekonomisë
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MITIK	Ministria e Inovacionit, Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit
MSIAP	Ministria e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
TEDA	Zonë e Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik
TIK	Teknologji e Informacionit dhe Komunikimit
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

PËRMBAJTJA

HYRJE	5
METODOLOGJIA	7
KONTEKSTI	8
GJETJE	17
1. Qeverisja e Ekosistemit të Inovacionit parë në këndvështrimin e biznesit.....	17
2. Biznesi kundrejt inovacionit	21
3. Burimet financiare në mbështetje të inovacionit në Shqipëri	27
4. Të tjera.....	29
REKOMANDIME	32
1. Qeverisja – Kuadri Ligjor dhe Rregullator.....	32
2. Bashkëpunimi "Quadruple helix" (Qeveri - Universitet – Biznes – Shoqëri Civile/Media)...	34
5.1 Aksesit në financim.....	35
5.2 Nxitja e potencialeve të ekonomisë dixhitale dhe krijimi i sinergjive midis palëve të interesuara	35
SHTOJCË	37
BIBLIOGRAFIA	39

HYRJE

Nërsa pandemia e COVID-19 vazhdon të sjellë goditje te forta në ekonominë globale, ajo po nxit gjithashtu inovacionin në industri të ndryshme në mbarë globin. Këto kohë të trazuara kanë krijuar edhe perspektiva inovative për biznesin duke vënë në pah edhe trende drejt mundësive të reja të investimit. A do të shndërrohen këto “mundësi” të reja dhe “risikoze” të krijuara si pasojë e COVID-19, në potencial rritjeje sistematike pas pandemisë? Tranzicioni dixhital do të ketë një ndikim të qëndrueshëm në shoqëri. Si duhet të ndërtojmë një ekonomi dixhitale gjithëpërfshirëse¹ pas COVID-19? Si do të veprohet duke ditur që jo të gjithë e kanë mundësinë për të kaluar me shpejtësi në modelin dixhital? Për të kapërcyer me sukses sfidat dhe për të mbështetur rezultatet, studimet e fundit kanë treguar se sa e rëndësishme është ekzistenca e një kuadri mbështetës për bizneset². Shpesh theksohet se ajo mund të ndihmojë drejtuesit e bizneseve të njohin kapacitetet e reja inovative brenda kompanive të tyre dhe të vendosin se ku mund të jetë më mirë për të investuar në afatgjatë.

COVID-19 i dha një goditje të madhe kompanive

shqiptare, por megjithatë vendi nuk veçohet nga vendet e tjera për sa i përket ndikimit: p.sh. 71% e kompanive në Shqipëri raportuan një rënie të kërkesës, e cila është më pak e rëndë se në Greqi dhe Moldavi, e krahasueshme me Italinë, Gjeorgjinë dhe Bullgarinë, dhe më keq se në Slloveni dhe Kroaci. Në të njëjtën kohë, kompanitë shqiptare u treguan tepër fleksibile, duke treguar se përsheptimi i dixhitalizimit mund të rrisë aftësinë e bizneseve jo vetëm për të përballuar krizën, por edhe për të zgjeruar aksesin në tregjet e reja dhe për të rritur shitjet³.

Sipas Raportit të Progresit të BE-së (2020), Shqipëria ka bërë disa përparime dhe është mesatarisht e përgatitur për zhvillimin e një ekonomie funksionale tregu⁴. Më konkretisht, aftësia konkurruese e Shqipërisë është përmirësuar në infrastrukturë, energji, transport dhe komunikim dixhital, por kjo pengohet për shkak të mungesës së ekspertizës sipërmarrëse dhe teknologjike, hende kut të konsiderueshëm të aftësive punëtore, institucioneve të dobëta, niveleve

3 <https://blogs.worldbank.org/developmenttalk/covid-19-impact-albanias-private-sector-taking-stock-looking-ahead>

4 Shqipëria ka bërë disa përparime dhe ka një farë niveli të përgatitjes për sa i përket kapacitetit për të përballuar presionin konkurrues dhe forcat e tregut brenda Bashkimit. Infrastruktura në energji, transport dhe komunikim dixhital, si dhe rezultatet arsimore janë përmirësuar, por ka ende boshllëqe të konsiderueshme krahasuar me nivelet rajonale dhe evropiane.

1 “Going digital: How to build an inclusive digital economy in the wake of COVID 19”

2 A framework for Innovation in the COVID-19 Era and Beyond (17 February 2021), MIT

të ulëta të investimeve dhe cilësisë së infrastrukturës. Në nivelin strategjik, angazhimi i Qeverisë Shqiptare për dixhitalizimin dhe inovacionin është evidentuar tashmë në disa nisma strategjike dhe dokumente të politikave (rajonale, kombëtare, ose si pjesë e pajtueshmërisë me procesin e përafrimit me BE, OECD, etj.)⁵, mbështetur gjithashtu edhe me projekte përkatëse nga donatorët, iniciuar përpara pandemisë së COVID-19. Ndonëse, Shqipëria merr pjesë në shumë programe të BE-së, është evidentuar një qasje e kufizuar e sektorit privat shqiptar në projekte përkatëse (të tilla si COSME, Horizon 2020, Erasmus Plus), nëse bëjmë një krahasim me vendet e tjera të rajonit.

Që prej janar 2021, inovacioni në sipërmarrje konsiderohet si një përparësi nga anëtarët e Këshillit të Investimeve (KI). Kjo tematikë, në fakt është vlerësuar si prioritare nga KI që prej vitit 2017 kur u diskutua mbi cilësinë e aftësisë punëtore në vend dhe mundësive të investimit për sektorët e rinj në zhvillim⁶.

Objekti kryesor i këtij studimi është të ndihmojë në përshpejtimin e agjendës kombëtare për inovacionin në sipërmarrje me qëllim maksimizimin e iniciativave dhe mbështetjeve të ndryshme që vendi ka ndërmarrë. Gjithashtu, ky studim synon stimulimin e mëtejshëm të debatit

se si bizneset shqiptare (veçanërisht NVM-të) të jenë jo vetëm “konsumatore” të inovacionit, por edhe “prodhuese” të tij në kontekstin e ekonomisë dixhitale.

Më konkretisht, bazuar në një vërtetim të kohëve të fundit me sektorin privat (me pjesëmarrjen e 75 kompanive), kjo analizë synon të adresojë çështje që lidhen me (1) Inovacionin dhe rolin e institucioneve publike për të mundësuar funksionimin e duhur të ekosistemit për bizneset shqiptare për të thithur potencialet e ofruara nga inovacioni; (2) Sfidat e kompanive shqiptare që kanë të bëjnë me paaftësinë e tyre për të inovuar; dhe (3) Ndërveprimin dhe mbështetjen e ofruar përmes instrumenteve të ndryshëm (apo edhe donatorëve) në drejtim të inovacionit në sipërmarrje.

Për qëllimet e kësaj analize, Sekretariati iu referua përkufizimit gjithëpërfshirës mbi inovacionin të OECD⁷, e cila e përcakton atë bazuar në 4 shtylla: zhvillimi i një produkti të ri ose të përmirësuar ndjeshëm (produkt ose shërbim), ose procesi, një metodë e re e marketingut, ose një metodë e re organizative në praktikën e biznesit, organizimin e vendit të punës ose marrëdhëniet e jashtme. Ky përkufizim mundëson pasqyrim të inovacionit që start-up sjellin në ekonomi dhe inovacionin e përqafuar nga kompanitë ekzistuese në treg.

⁷ OECD, 2005, “The Measurement of Scientific and Technological Activities: Guidelines for Collecting and Interpreting Innovation Data: Oslo Manual, Third Edition” prepared by the Working Party of National Experts on Scientific and Technology Indicators, OECD, Paris, para. 146.

METODOLOGJIA

Metodologjia e studimit përfshin përdorimin e të dhënave cilësore dhe sasiore të mbledhura nga burime dytësore dhe primare, dhe bazohet në një mori hapash të ndërmarra nga Sekretariati për të stimuluar debatin mbi inovacionin si më poshtë:

- » Hulumtim të analizave dhe raporteve kombëtare, ndërkombëtare, dokumente, ligjeve dhe akteve nën-ligjore në lidhje me dimensionet e ndryshme të inovacionit.
- » Analizimin e informacionit zyrtar nga burimet dytësore (INSTAT, BB, DPT, etj.) si dhe informacionet/të dhënat kryesore të mbledhura gjatë intervistimit të aktorëve të ekosistemit të inovacionit.
- » Përgjigjet e marra nga pyetjet e drejtuara tek të gjithë anëtarët dhe partnerët e KI-së mbi këndvështrimin e tyre për çështje që lidhen me (1) *Inovacionin dhe rolin e institucioneve publike për të mundësuar funksionimin e duhur të ekosistemit*, (2) *Sfidat e përgatitjes së sipërmarrjes shqiptare për t'u përballur me inovacionin apo pamundësinë për të krijuar*

ndërveprim dhe mbështetje të inovacionit, (3) bashkëveprimi dhe mbështetja e ofruar përmes instrumenteve të ndryshëm apo donatorëve në drejtim të inovacionit në ndërmarrje.

- » Pyetësorit të zhvilluar nga Sekretariati i KI-së për të eksploruar perceptimin e biznesit në lidhje me ekosistemin e inovacionit, sfidat dhe mundësitë e hasura dhe informacionin mbi fondet e disponueshme kombëtare dhe ndërkombëtare që financojnë inovacionin e sektorit privat. *Gjithsej 75 kompani plotësuan pyetësin nëpërmjet internetit.*
- » 30 takime virtuale mbajtur gjatë periudhës shkurt-mars 2021 me aktorë të ndryshëm të ekosistemit: institucione publike, universitete publike dhe private, donatorë, kompani start-up dhe biznese të konsoliduara që punojnë në fushën e inovacionit.
- » 1 takim në nivel teknik (12 mars 2021) organizuar me pjesëmarrjen e 33 aktorëve ku u diskutuan gjetjet dhe çështjet e ngritura gjatë pyetësorit të Sekretariatit dhe konsultimeve të drejtpërdrejta me aktorë të ndryshëm.

⁵ Smart Specialization (S3)

⁶ <https://www.investment.com.al/sq/meeting/mbledhja-nr-9-afesite-e-tregut-te-punet-ne-sektorin-e-bpo-ve/>

KONTEKSTI

Shqipëria renditet e 83-ta në Indeksin Global të Inovacionit⁸ krahasuar me 131 ekonomi botërore (e 39-ta në 39 ekonomitë e Evropës). Pozicioni i Shqipërisë për tre vitet e fundit, 2018-2020, ka qenë i qëndrueshëm në vendin e 83-të, pa ndonjë përmirësim të madh në renditjen globale. Shqipëria performon më mirë në komponentin “*Institucione dhe Infrastrukturë*”, dhe më keq në “*Njohuri dhe Produkte teknologjike*” dhe “*Kapitali human dhe kërkimor*”⁹. Kapaciteti për kërkim, zhvillim dhe inovacion konsiderohet si shumë i ulët, pasi shpenzimet publike për kërkime mbetën të papërfillshme në 0,06% të PBB-së¹⁰ dhe përqindja e kompanive që investojnë në K&ZH (rreth 15%¹¹) është e dyta më e ulta në rajon. Në indeksin e konkurrueshmërisë globale, Shqipëria renditet veçanërisht poshtë

8 https://www.wipo.int/edocs/pubdocs/en/wipo_pub_gii_2020/al.pdf


9 Për më shumë info [kliko këtu](#)

10 ERP 2021-2023

11 Albania Enterprise Survey 2019, WB, EBRD, EIB,

për aftësinë e inovacionit (110 nga 141 ekonomi) dhe K&ZH (126/141).

Figura 1. Renditja e Shqipërisë sipas Indikatorit Global të Inovacionit (IGI) 2020



Burimi: GII Report 2020

Në Indeksin e fundit të publikuar të Politikave të NVM-ve 2019¹², OECD shprehet se Shqipëria është një performuese e nivelit të mesëm mbi politikën e inovacionit në rajon (renditet e pesta nga shtatë ekonomitë e Ballkanit Perëndimor për këtë dimension). Shqipëria¹³ mbetet ende lider rajonal për mjedisin operacional të NVM-ve falë hapave

12 <https://www.oecd.org/countries/albania/sme-policy-index-western-balkans-and-turkey-2019-g2g9fa9a-en.htm>

13 Pavarësisht uljes së pikëzimit nga 4,32 në 3,99 që nga vlerësimi i fundit

të bërë në regjistrimin dhe licencimin e biznesit, si dhe shpërndarjen e shërbimeve publike. *Ky dimension i politikës përfaqëson performancën më të fortë të Shqipërisë*¹⁴. Sidoqoftë, nuk ka fusha të veçanta të politikës së inovacionit në të cilën Shqipëria dallohet pasi rezulton afër mesatares rajonale në të gjitha nën-dimensionet.

14 Me një pikëzim të ngjashëm me Malin e Zi (2,53), Shqipëria kalon Kosovën (2,40) dhe Bosnje & Hercegovinën (1,86)

Tabela 1. Politika e Inovacionit për NVM

	ALB	BIH	KOS	MKD	MNE	SRB	TUR	BP
Qasja strategjike	3.60	2.25	2.90	3.80	3.45	3.60	4.60	3.46
Koordinimi i politikave të inovacionit	2.33	1.44	2.33	3.67	2.33	3.67	5.00	2.97
Vënia në zbatim e politikave të inovacionit	2.57	1.86	2.43	4.14	2.57	4.14	3.57	3.04
Kuadri politik mbi inovacionin (mesatare e ponderuar)	2.83	1.89	2.55	3.94	2.79	3.88	4.17	3.15
Inkubatorët dhe akseleratorët	1.71	2.24	3.00	3.14	3.00	3.43	4.43	2.99
Shërbime të "ekstensionit" të teknologjisë për NVM-të e themeluara	2.50	1.00	1.00	2.67	1.00	1.00	3.00	1.74
Shërbimet mbështetëse institucionale të qeverisë për NVM-të inovative (Mesatarja e ponderuar)	2.03	1.74	2.20	2.95	2.20	2.46	3.86	2.49
Mbështetje direkte financiare	3.80	2.53	3.40	4.20	3.40	4.20	4.80	3.76
Mbështetje in-Direkte financiare	1.00	1.00	1.00	1.22	1.00	1.00	3.44	1.38
Shërbimet e mbështetjes financiare të qeverisë për NVM-të inovative (Mesatarja e ponderuar)	2.68	1.92	2.44	3.01	2.44	2.92	4.26	2.81
Skemat e kuponave të inovacionit dhe grante bashkëpunuese	2.00	1.67	2.00	3.00	2.00	4.00	3.00	2.52
Infrastruktura institucionale për bashkëpunimin e industrisë dhe sektorit akademik	1.80	1.67	2.40	2.80	2.80	3.00	4.60	2.72
Të drejtat e pronësisë intelektuale	2.50	2.50	2.50	3.00	2.50	3.50	4.50	3.00
Bashkëpunimi i NVM-ve dhe institucioneve kërkimore dhe transferimi i teknologjisë (Mesatarja e ponderuar)	2.02	1.83	2.26	2.92	2.42	3.5	3.94	2.70
Rezultati i Përgjithshëm për Politikën e Inovacionit	2.48	1.86	2.4	3.35	2.53	3.33	4.08	2.86

Burimi: Indeksi i Politikave të NVM-ve, Ballkani Perëndimor dhe Turqia (OECD, 2019)

Në vitin 2019, një vlerësim i përbashkët nga Bashkimi Evropian, OECD, BERZH dhe ETF ka vlerësuar progresin e bërë nga Shqipëria në zbatimin e SBA¹⁵ gjatë periudhës 2016-18. Një nga përparësitë e njohura ishte nevoja për të rritur mbështetjen për infrastrukturën e inovacionit për të avancuar bashkëpunimin biznes-akademi.

Megjithëse pandemia e COVID-19 shkaktoi efekte negative të jashtëzakonshme në ekonominë tonë, ajo gjithashtu përshpejtoi përdorimin e mjeteve inovative të biznesit. Anketa jonë mbi impaktin e COVID-19 mbi bizneset shqiptare (prill 2020) tregoi që kompanitë u bënë më të vetëdijshme për mundësitë e mundshme të ofruara nga shërbimet në internet dhe rëndësinë e përdorimit të ideve inovative në biznes, veçanërisht për masat e vazhdimësisë së biznesit. Rreth 75% e kompanive deklaruan të kenë përdorur shërbime në internet dhe 81% e tyre deklaruan se do të vazhdojnë t'i ripërdorin ato në të ardhmen. Për më tepër, kur u pyetën për planet e tyre të ardhshme mbi inovacionin, 38% e kompanive ishin pozitive në ndryshimin e planit të tyre të investimeve në drejtim të shërbimeve online.

Raporti IGI 2020 nënvizon se *“Pasi pandemia e COVID-19 të jetë nën kontroll, është e rëndësishme që mbështetja për inovacionin të zgjerohet përtej sektorit shëndetësor dhe që shpenzimet e qeverisë për inovacion të kompensojnë çdo rënie të financimit të inovacionit të sektorit privat. Ndikimet e pandemisë në sistemin e shkencës dhe inovacionit duhet të monitorohen. Disa efekte pozitive janë vërejtur tashmë, të tilla si niveli i papritur i bashkëpunimit ndërkombëtar në shkencë dhe zvogëlimi i burokracisë për shkencëtarët. Sidoqoftë, disa aspekte janë alarmante, siç janë ngecja e projekteve të mëdha kërkimore*

15 <https://www.etf.europa.eu/en/publications-and-resources/publications/sme-policy-index-western-balkans-and-turkey-2019-assessing>

dhe ulja e mundshme (dhe e pabarabartë) e shpenzimeve të K&ZH në disa fusha.”

Analizat e INSTAT¹⁶ (2017-2019) tregojnë se në Shqipëri vetëm 38% e kompanive deklarojnë se kryejnë një aktivitet inovacioni, kryesisht kompanitë që operojnë në sektorin e shërbimeve¹⁷ (42,2%) dhe kompanitë që operojnë në sektorin e industrisë¹⁸ (34%). Asnjë pjesëmarrje aktive në Inovacion nuk vërehet nga kompanitë që operojnë në sektorë me përparësi si bujqësia dhe turizmi.

Në Raportin e Progresit të BE-së 2020, Shqipëria konsiderohet në një fazë të hershme në fushën e shkencës dhe kërkimit. Disa përparime u bënë gjatë vitit 2020, veçanërisht me përfundimin e fazës së hartëzimit të Strategjisë së Specializimit të Zgjuar. Hartimi i Strategjisë së Specializimit të Zgjuar (S3) filloi në 2017 nën udhëheqjen e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në bashkëpunim me Komisionin Evropian; u hartua një plan aktivitetesh (*road map*) për procesin S3 dhe faza e hartëzimit të procesit S3 përfundoi në dhjetor 2019 me mbështetjen e BE¹⁹.

Gjithashtu, në vlerësimin e Komisionit Evropian për Programin e Reformës Ekonomike të Shqipërisë 2020-2022, vërehet se *Qeveria duhet të përmirësojë ofrimin e shërbimeve të mbështetjes teknike për ndërmarrjet mikro, të vogla*

16 INSTAT kliko [ketu](#)

17 Tregëti, Transport dhe Magazinim, Informacion dhe Komunikime, Shërbime Financiare dhe Sigurime

18 Industri nxjerrëse, Manufakturë, Energji, Furnizim Uji, Largim i ujërave dhe trajtim i tyre.

19 Është me një rëndësi të veçantë përdorimi i Fondeve Strukturore Evropiane dhe të Investimeve për të sjellë rajonet në ekonominë e inovacionit. Strategjitë e Specializimit të Zgjuar duhet të forcohen dhe modernizohen për të mundësuar mbështetjen ndër-rajonale të inovacionit. Duhet të krijohen sinergji, me programin Horizon Europe, Programin InvestEU, Fondin Social Evropian, Programin Erasmus +, Programin e Evropës Dixhitale, Politikën e Përbashkët Bujqësore dhe programe të tjera.

dhe të mesme, përfshirë edhe zhvillimin e një rrjeti mbështetës për të ndihmuar ato të rriten, investojnë, përtërijnë, dixhitalizojnë dhe eksportojnë. Aktualisht, është në diskutim një Strategji e re për Zhvillimin e Biznesit dhe Investimeve (2021-2027), e planifikuar për miratim në fund të vitit 2021. Shqipëria vazhdon të zbatojë iniciativën dhe veprimet rajonale të Evropës Jug-Lindore 2020 nën Planin Shumëvjeçar të Veprimit të Ballkanit Perëndimor për zhvillimin e Zonës Ekonomike Rajonale (MAP-REA)²⁰. *Shqipëria paraqitet mjaft mirë në drejtim të depërtimit të broadband (rreth 63%) ndërsa depërtimi i brezit fiks në familje mbetet një sfidë.* Përafërsisht 38% e popullsisë ka qasje në internet fiks ndërsa hendeuku midis aksesit në internet në zonat rurale dhe urbane mbetet i madh. Tregtia elektronike pengohet nga sfidat në legjislacionin për mbrojtjen e konsumatorit dhe mungesa e aftësive dixhitale është akoma e pranishme²¹.

Qeveria Shqiptare gjithashtu ka pohuar angazhimin e saj të plotë për Agjendën 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm (SDG). Inovacioni përfshihet në Qëllimin 9 Industria, Inovacioni dhe Infrastruktura’ të Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, duke synuar promovimin e industrive të qëndrueshme dhe investimin në kërkimin shkencor dhe inovacionin që lehtësojnë zhvillimin e qëndrueshëm. Për të mbështetur veprimin e SDG, Shqipëria ka përgatitur një raport bazë të SDG për të eksploruar përbërësit specifik të shtyllave të Strategjisë Kom-

20 Plani Shumëvjeçar i Veprimit (MAP) për një Zonë Ekonomike Rajonale (REA) në Gjashtë të Ballkanit Perëndimor (BB), (miratuar nga Kryeministrat e Ballkanit Perëndimor në Samitin e Triestes korrik 2017) ndihmon në rritjen e bashkëpunimit ekonomik rajonal përmes: avancimit të tregtisë rajonale integrimi, rritja e konkurrencës dhe çlirimi i potencialeve për rritje, promovimi i rajonit si një hapësirë unike për investime, krijimi i kushteve më të mira për të siguruar lëvizjen e lirë të profesionistëve dhe njerëzve të aftë, dhe lidhja dixhitale e bizneseve dhe qytetarëve

21 MAP REA Report 2019

bëtare të Zhvillimit dhe Integritimit (NSDI). Sfidat kryesore në këtë proces përfshijnë ndër të tjera *“identifikimin e boshllëqeve të politikave dhe përshpejtimin e veprimit në fushat me përparësi, përfshirë institucionet e monitorimit dhe raportimit”*.

Bazuar në kompleksitetin e dinamikës së mësipërme dhe gjetjet nga konsultimi ynë i fundit mbi perceptimin²² e inovacionit të sektorit privat, ekosistemi i inovacionit në Shqipëri konsiderohet në një fazë shumë të hershme, megjithëse një numër i konsiderueshëm i aktorëve janë funksionalë, por pa një vizion të qartë dhe nganjëherë me mbivendosje aktivitetesh mes tyre. Ekzistojnë projekte në vazhdim që synojnë të mbështesin kompanitë në faza të ndryshme të inovacionit, megjithëse këto nisma mbeten pa një objektiv për shfrytëzimin e të gjitha njohurive të transferuara. Ka mungesë të informacionit të konsoliduar mbi hartëzimin e donatorëve në lidhje me fondet në dispozicion për financimin e inovacionit. Universitetet nuk po luajnë një rol proaktiv për të siguruar një lidhje të sigurt midis forcës së punës dhe biznesit për të siguruar sisteme të qëndrueshme.

1. KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

Në këtë seksion jepet vetëm një përmbledhje e shkurtër e kornizës së strategjive, institucioneve dhe akteve ligjore kryesore të zbatueshme në lidhje me inovacionin, duke përfshirë por jo e kufizuar vetëm në TIK. Ne vërejmë se kuadri institucional dhe ligjor që mbulon segmente të inovacionit dhe që parashikon një përzierje të përkufizimeve në lidhje me të është shumë i gjerë nëse merren parasysh këtu fushat si tregtia elektronike, dixhitalizimi, bazat e të dhënave dhe shërbimet publike, dokumenti elektronik dhe nënshkrimet elektronike, infrastruktura *broadband*, etj.

22 <https://sustainabledevelopment.un.org/memberstates/albania>

23 Konsultimet e Sekretariatit gjatë shkurt-mars 2021

Qëllimi i përmbledhjes është të nxjerrë në pah shkurtimisht kontekstin e zhvillimeve kryesore me fokus inovacionin, kërkimin dhe zhvillimin. Objektivi i tij kryesor mbetet të nxjerrë në pah dinamikat e kohëve të fundit në lidhje me qeverisjen dhe mundësitë e reja për tregun në fushën e inovacionit që rrjedhin nga një legjislacion i tillë.

a. Strategjitë kombëtare

Strategjia Ndërsektorale "Axhenda Dixhitale e Shqipërisë" (2015-2020)²⁴

Më tepër se një strategji e dedikuar për inovacionin, ajo ishte një dokument "ombrellë" e të gjitha objektivave dhe synimeve në kuadrin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit me fokusin kryesor tek dixhitalizimi. Strategjia u përgatit nga Ministria e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike. Ajo përfshiu dhe miratoi një spektër të përgjithshëm të aktiviteteve që rrjedhin nga *Agjenda Dixhitale për Evropën* dhe dimensionet e saj prioritare²⁵. Korniza e objektivave, qëllimeve dhe strategjisë u bazua në një pasqyrë të përgjithshme të të gjitha premisave për zhvillimin e TIK dhe shërbimeve të dixhitalizuara si në sektorin privat ashtu edhe në atë publik. Ajo përfshinte infrastrukturën dhe edukimin për TIK-ut, internetin, zhvillimin e *broadband*, qeverisjen elektronike, shërbimet e shoqërisë së informacionit dhe komunikimet elektronike.

Inovacioni ishte pjesë e shtyllës së kërkimit shkencor dhe inovacionit me fokus: (a) zgjerimin dhe rritjen e cilësisë së kërkimit shkencor dhe in-

ovacionit në Shqipëri bazuar në treguesit e OECD; (b) rritja aktive e përfshirjes së institucioneve kërkimore shkencore në Zonën Evropiane të Kërkimit (ERA), (c) përmirësimi i cilësisë dhe orientimit të kërkimit shkencor drejt nevojave të tregut përmes forcimit të lidhjeve të programeve kombëtare dhe ndërkombëtare me biznesin.

Në lidhje me biznesin, fokusi i strategjisë ishte në inovacionin e NVM-ve dhe zhvillimin e TIK-ut për bizneset e vogla dhe mesatare. Objektivi i saj kryesor ishte të rriste me 50% numrin e bizneseve që përdorin TIK dhe me 10% numrin e bizneseve në sektorin e TIK.

Strategjia Kombëtare e Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit 2017-2022²⁶

U përgatit nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Strategjia mbështetej në drejtimet e mëposhtme të cilat përqendrohen kryesisht në komponentin e kërkimit shkencor: (1) Maksimizimi i rezultateve të kërkimit shkencor në nivel kombëtar; (2) Forcimi i lidhjeve ndërkombëtare dhe rajonale në fushën e kërkimit shkencor; (3) Hapja e tregut kombëtar për studiuesit e huaj; (4) Rritja e barazisë gjinore ndërmjet studiuesve në universitete dhe qendrave kërkimore; (5) Aksesimi në informacionin shkencor. **Ndërlidhja kryesore dhe e vetme me biznesin është para-shikimi i mekanizmit Triple Helix si një mjet për bashkëpunim midis institucioneve-akademisë-biznesit-shoqërisë civile.**

Programi i Reformave Ekonomike 2021-2023 (ERP)²⁷

Është dokumenti kryesor strategjik që trajton inovacionin nga një perspektivë e fortë biznesi dhe fokusohet në shtyllën e kërkimit, zhvillimit, inovacionit dhe

²⁴ Miratuar me VKM nr. 284 datë 01.04.2015, paraprihej nga Strategjia Ndërsektorale për Shoqërinë e Informacionit 2008-2013 dhe Strategjia Kombëtare e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit 2003.

²⁵ (1) Një treg i vetëm dixhital; (2) Standardet dhe bashkëpunimi; (3) Besimi dhe Siguria; (4) Qasja në internet të shpejtë dhe ultra-të shpejtë; (5) Kërkimi dhe Inovacioni; (6) Përmirësimi i njohurive, aftësive dhe përfshirjes dixhitale; (7) Përfitimet e TIK-ut për të gjithë shoqërinë.

²⁷ Miratuar me VKM nr. 37 datë 27.01.2021.

ekonomisë dixhitale. Reformat kryesore nën këtë shtyllë janë: (1) Përmirësimi i kapaciteteve institucionale, financiare dhe njerëzore për kërkime dhe inovacion; dhe (2) Zhvillimi i infrastrukturës *broadband* dhe ekonomisë dixhitale. Programi konsideron veprimet dhe masat me afate kohore specifike, duke filluar nga miratimi i legjislacionit për start-up inovative dhe konsolidimi i ekosistemit, rritja e aksesit në financa për kompanitë start-up përmes krijimit të fondit të inovacionit, funksionimit efektiv të mekanizmave *triple-helix*, zhvillimit të zgjidhjeve inovative me qasje sektoriale (qeveri, shëndetësi, etj.), etj. *ERP 2021-2023 i referohet të njëjtave shtylla të masave siç përmenden në strategjitë e mësipërme, por me një fokus të dedikuar për sipërmarrjen dhe do të shërbejë si dokument referimi për matjen e arritjeve dhe objektivave.*

b. Ndërlidhja e politikave të inovacionit ndërmjet institucioneve të ndryshme

Institucioni politikëbërës në fushën e teknologjisë dhe inovacionit ka qenë fillimisht MITIK-Ministria për Inovacionin, Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit e cila u krijua në 2009 me fokus në nxitjen e sektorit TIK në fushën e shërbimeve publike dhe nxitjen e inovacionit. Pas vitit 2013 politikat në fushën e teknologjisë dhe inovacionit u përfshinë në fushën e veprimtarisë së Ministrisë së Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike²⁸ dhe Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes. Në vitin 2017 me riorganizimin e ministrive, Ministria e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike u shkri dhe funksionet e saj u ndanë midis një sërë institucioneve si

²⁸ VKM nr 943, datë 9.10.2013 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike".

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë dhe Ministria sëe Financave dhe Ekonomisë. Nga ana tjetër vetë Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes u shkri dhe funksionet dhe përgjegjësitë e saj i kaluan Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

Në nivelin e agjencive, institucionet të cilat janë përgjegjëse për aspekte të inovacionit janë AKSHI dhe AKKSHI. AKSHI ofron politika, strategji dhe rregullon sektorin TIK, duke përjashtuar fushën e komunikimeve elektronike. AKSHI është ofrues i shërbimeve TIK dhe i shërbimeve elektronike për qytetarët, bizneset dhe administratën publike²⁹. AKKSHI ka për mision të nxisë kërkimin shkencor dhe inovacionin, nëpërmjet mbështetjes, monitorimit e vlerësimit të programeve dhe projekteve në fushën e shkencës, teknologjisë dhe inovacionit (SHTI), si dhe administrimin e përditësimit e bazës kombëtare të të dhënave për kërkimin shkencor dhe inovacionin³⁰. Në vija të përgjithshme ndërsa kërkimi shkencor ka qenë pjesë e politikave në fushën arsimore, *inovacioni ka mbetur një shtyllë pa një domain të qartë institucional.*

c. Një vështrim mbi iniciativat kryesore ligjore për të mbështetur inovacionin dhe teknologjinë

Masat dhe stimujt fiskalë për të mbështetur inovacionin dhe TIK. Në Paketën Fiskale 2017 u parashikua një ulje e tatimit fitimit të personave

²⁹ VKM nr. 673 datë 22.11.2017 "Për Riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, i ndryshuar me Vendim nr. 36, datë 24.1.2018, Me Vendim nr. 448, datë 26.7.2018, Me Vendim nr. 872, datë 24.12.2019.


³⁰ VKM nr. 607 datë 31.08.2016 "Për Krijimin, Përbërjen, Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI).

juridikë që operojnë në fushën e “prodhimit të programeve kompjuterike” nga 15% në 5%. Ky stimul u krijua në kuadrin e stimujve sektorial fiskalë dhe si një instrument për të mbështetur dhe mbajtur kapacitetet intelektuale brenda vendit, si një faktor kryesor për zhvillimin teknologjik dhe ekonomik. Edhe pse mjaft i vlerësuar nga biznesi, ende nuk ka ndonjë publikim zyrtar të ndikimit të tij në rritjen e sektorit të TIK. Sipas të dhënave të marra nga DPT, konstatohet një rritje

e numrit të kompanive të regjistruara në sektorin e TIK me 46% nga viti 2018 në 2019, duke sjellë një rritje prej 12% të aktivitetit ekonomik dhe 23% në numrin e të punësuarve³¹. Ndikimi i këtij stimuli fiskal u konfirmua gjithashtu edhe gjatë konsultimit tonë me përfaqësuesit e biznesit gjatë periudhës shkurt - mars 2021.

31 Llogaritjet e Sekretariatit sipas të dhënave nga DPT.

Figura 2. Të dhëna mbi sektorin TIK pas stimullit fiskal



Burimi: DPT dhe përlogaritjet e Sekretariatit

Plani Kombëtar për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Infrastrukturës Digjitale Broadband 2020-2025³²

Dokumentin e njeh rëndësinë e TIK dhe transformimit dixhital në zhvillimin shoqëror dhe ekonomik. Për këtë qëllim, infrastruktura me bandë të gjerë dhe me shpejtësi të lartë konsiderohet si një përparësi kryesore midis premisave për mbështetjen e TIK, dixhitalizimit dhe inovacionit në vend. Plani parashikon 3 objektiva strategjike: (1) Zhvillimi i qëndrueshëm i infrastrukturës *broadband*; (2) Reduk-

timi i ndarjes dixhitale dhe ofrimi i shërbimeve gjithëpërfshirëse të *broadband*; (3): Kërkesa në rritje për zhvillimin e ekonomisë dixhitale dhe një shoqërie *Gigabit*. Këto objektiva ndahen më tej përmes objektivave dhe afateve specifike për periudhën 2020-2025, ndër të cilat vihet re: *Deri në fund të vitit 2025, një qytet i madh, korridoret kryesore të transportit dhe vendet strategjike, që do të mbulohen nga lidhja 5G*. Duke marrë në konsideratë investimet e mëdha të kërkuara për zbatimin e tij, plani parashikon modele të ndryshme financimi të përdorura për infrastrukturën me bandë të gjerë që përfshijn fonde publike dhe private.

32 Miratuar me VKM Nr.434 date 03.06.2020.

Ligji nr. 9789/2007 “Për Krijimin dhe Funksionimin e Zonave Ekonomike” u ndryshua me Ligjin nr. 54/2015 “Për Krijimin dhe Funksionimin e Zonave të Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik-TEDA”, parashikon stimuj specifike fiskale për aktivitetin ekonomik të industrive të reja, teknologjive inovative, teknologjive të informacionit, industrive që plotësojnë standardet ndërkombëtare të eliminimit të ndotjes, industrive efikase në përdorimin e energjisë, si dhe industritë me produktivitet të lartë, në lidhje me punonjësit. Objektivi kryesor i këtij ligji është tërheqja e investitorëve të huaj të mundshëm për të zhvilluar një model biznesi subjekt i incentivave financiarë dhe administrative në një pronë të dedikuar shtetërore me infrastrukturë të mbështetur nga shteti. Megjithatë ky ligj u mbështet nga një sërë aktesh nënligjore³³, ende sot nuk ka ndonjë TEDA funksionale.

Urdhëri nr. 1 datë 10.01.2017 i Kryeministrit për Miratimin e Planit të Veprimit 2017 - 2021 “Mbështetje për Zhvillimin e Politikave Inovative Bazuar në Modelin TRIPLE HELIX”: Plani i veprimit parashikonte 12 aktivitete dhe një grup të madh masash konkrete për të trajtuar disa çështje të ekosistemit në kuadrin e një grupi pune të dedikuar. Ai përfshinte midis të tjerave krijimin e një rrjeti virtual për mbështetjen e inovacionit, promovimin e bashkëpunimit Biznes-Akademik-Qeveri, sigurimin e mbështetjes për programet e inkubatorëve dhe përsheptuesve, krijimin e një rrjeti të engjëjve të biznesit dhe një sërë masash të tjera. Sekretariati nuk mundi të gjente ndonjë raport zyrtar të monitorimit mbi aktivitetet e drejtuara dhe masat e zbatuara. **Projektligji “Për Mbështetjen dhe Zhvillimin e Startup-eve Inovative”** u përgatit dhe u lançua për konsultim publik në fund të 2020 si një

33 Regullore për Funksionimin e TEDA e miratuar me VKM Nr.106 datë 10.02.2016.

bashkë-iniciativë e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrisë së Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes. Projektligji synon të krijojë një kornizë rregullatore dhe institucionale e cila mbështet dhe favorizon krijimin dhe zhvillimin e ndërmarrjeve të reja në fushën e teknologjisë dhe inovacionit, me potencial të lartë rritjeje të njohur në të gjithë botën si Start-Up Inovative. Projektligji fillon në një kontekst kur ekosistemi i palëve të interesuara nuk është konsoliduar ende, numri i iniciativave dhe mbështetjes së projekteve donatore ka qenë shumë dinamik dhe kur tregu kërkon produkte dhe zgjidhje inovative për të rritur aftësinë konkurruese të ndërmarrjeve, veçanërisht në kontekstin e pandemisë së Covid-19. Objektivat e projektligjit janë si më poshtë:

1. Përcaktimi i mekanizmave stimulues, të cilët përfshijnë lehtësira fiskale, programe dhe masa që mbështesin startup-et inovative në fazën fillestare të biznesit (periudha e inkubacionit) dhe krijimin e një ekosistemi të favorshëm për to në Republikën e Shqipërisë;
2. Përcaktimi i kornizës institucionale dhe organeve shtetërore të cilët janë përgjegjës për detyrat dhe kompetencat për të mbështetur startup-et inovative;
3. Përcaktimi i kriterëve, rregullave dhe procedurave që zbatohen për miratimin, mbështetjen dhe monitorimin e startup-eve inovative.

Sekretariati i KI në fund të vitit 2020 lehtësoi konsultimin e projektligjit me komunitetin e biznesit dhe ofroi komente të hollësishme për grupin e punës mbi nenet dhe konceptet e përfshira në të për të mbështetur përmirësimin e mëtejshëm të tij dhe të lehtësojë zbatimin e tij.

Ligji nr. 66/2020 “Për Tregjet Financiare të Bazuar në Teknologji të Regjistruara të Shpërndarë” (blockchain) i miratuar në vitin 2020, ndjek një trend të fundit jo vetëm në nivelin e BE-së, të miratimit të masave rregullatore për të kontrolluar përdorimin e “Teknologjisë së Librave të

Shpërndarë-DLT” që mundëson kriptomonedhën dhe tokenat dixhitale. Ligji mundëson përfshirjen më të madhe të fondeve të mundshme nga FINTECH, gjetjen e burimeve alternative financiare të huaja dhe uljen e kostove të shërbimeve të pagesave. Krijon potenciale të reja për kompanitë fillestare dhe bizneset e reja që veprojnë në fushën e inovacionit. Ligji do të ndiqet me aktet nënligjore përkatëse, që synojnë të ofrojnë funksione rregullatore të Autoritetit Mbikëqyrës Financiar (AMF), si institucioni që vlerëson dhe mbikëqyr të gjitha aspektet rregullatore dhe pajtueshmërinë me kërkesat ligjore. Për më tepër, ato do të parashikojnë funksione të hollësishme të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), e cila vlerëson të gjitha aspektet dhe kërkesat teknologjike të paraqitura nga subjektet që kërkojnë të marrin një licencë për përdorimin e DLT.

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i miratuar së fundmi, mbështet konceptin e partneritetit për inovacion. Partneriteti për Inovacion është një formë specifike e prokurimit publik që synon të zhvillojë një produkt, shërbim ose punë inovative dhe më pas të blejë mallrat, shërbimet ose punët që rezultojnë nëse ato përputhen me nivelet e performancës dhe kostot minimale të rëna dakord midis autoritetit kontraktues ose entitetit dhe ndërmarrjeve të pjesëmarrësve në procesin e prokurimit.

Mekanizmat e Prokurimit Para-Komercial/Inovacionit që i mundëson sektorit publik të blejë shërbime kërkimore dhe zhvillimore (K&ZH) për probleme praktike dhe/ose sektoriale përdoren si mjete për të nxitur inovacionin në nivelin e BE-së. Ky instrument mundëson komisionimin e shërbimeve K&ZH, nën një proces konkurrues për të lejuar zhvillimin e zgjidhjeve inovative që plotësojnë nevojat e një Autoriteti Kontraktues. Kjo qasje bazohet në: 1. Ndarjen e përfitimit të rrezikut sipas kushteve të tregut; 2. Zhvillimin konkurrues në faza; dhe 3. Ndarjen e fazës së

K&ZH nga vendosja e vëllimeve komerciale të produkteve përfundimtare. Në nivel të BE-së ofrohen disa *shembuj* mbi modelet e suksesshme të prokurimit para-komercial, të cilat mund të hulumtohen më tej për kontekstin shqiptar.

Nisur nga ndërveprimi në rritje i ekosistemit dhe fokusi më i madh nga sektori publik dhe privat në TIK dhe inovacion, iniciativat e reja kanë filluar të japin një ndikim pozitiv. Iniciativa dhe projekti TUMO³⁴ është një model efektiv Triple Helix. Është një lloj i ri i përvojës arsimore në kryqëzimin e teknologjisë dhe dizajnit. Qendra TUMO për Teknologji të Arsimore filloi në Armeni, me mbi 14,000 studentë që vijojnë rregullisht të ndjekin qendrat në të gjithë vendin. TUMO është zgjeruar në një shkallë globale, në Paris, Moskë, Bejrut dhe Tiranë. Projekti kryqëzon vullnetin e disa aktorëve (TUMO, AADF, Bashkinë e Tiranës, Qeverinë Shqiptare) për të krijuar një strukturë të qëndrueshme në qendër të Tiranës duke u përqendruar në transformimin dixhital të të rinjve të moshave nga 12-18 vjeç në disa programe të tilla si: programimi, animacioni, zhvillimi i lojërave, krijimi i filmave në dizajn grafik, robotikë, muzikë, modelim 3D. Nga ajo që konfirmuam gjatë takimit me TUMO, projekti dhe programet janë zhvilluar me shpejtësi me një pjesëmarrje të lartë, ndërsa vërehet një interes në rritje nga biznese të tilla si bankat dhe kompanitë ndërkombëtare të BPO të cilat janë të interesuara të ofrojnë stazh për të rinjtë. Modele të ngjashme (laboratorë) po ndiqen edhe në Korçë dhe Vlorë, duke synuar krijimin e një grupi të madh programuesish për kompanitë kombëtare dhe ndërkombëtare.

34 <https://tirana.tumo.al/program/>

GJETJE

1. QEVERISJA E EKOSISTEMIT TË INOVACIONIT³⁵ PARË NË KËNDVËSHTRIMIN E BIZNESIT

1. **Pavarësisht dinamikave të fundit (kombëtare, rajonale dhe BE), përfshirë këtu edhe përpjekjet për stimuj fiskal, ende lidhshipi dhe qasja koherente ndaj inovacionit në ekosistemin e sipërmarrjes perceptohet si e kufizuar.** Aktualisht, ajo evidentohet të jetë e shpërndarë midis disa dokumenteve strategjike (të aprovuara, të vjetëruar, në proces) apo institucioneve/agjencive që reagojnë ndaj konceptit “inovacion” përmes masave specifike dhe projekteve të donatorëve. Nuk ka një përkufizim të qartë të ekosistemit të inovacionit, dhe as përcaktim të saktë sesi duhet të funksionojë për sa i përket roleve/funksioneve të përgjithshme të institucioneve (akademia, qeverisja lokale dhe/apo qendrore) dhe ndërveprimeve me aktorët e biznesit/lokal. Sa më sipër ka të bëjë me sa vijon:

35 “Ekosistemi i inovacionit” është termi i përdorur për të përshkruar aktorët e ndryshëm, grupet e interesit dhe anëtarët e komunitetit që janë të rëndësishëm për inovacionin. Secili luan një rol të rëndësishëm në krijimin e vlerës së shtuar në ekosistem duke shndërruar ide të reja në realitet përmes aksesit dhe investimeve financiare.

Institucionet


Qasja institucionale ndaj inovacionit është e fragmentuar ku disa përqendrohen në startup-et e TIK, disa në dixhitalizimin e shërbimeve publike, të tjerë në tregtinë e internetit dhe shërbimet e pagesave apo në transferimin e teknologjive. Përgjegjësitë e inovacionit janë të shpërndara mes ministrive dhe agjencive të ndryshme pa pasur askush udhëheqjen e procesit. Mungon qasja dhe sinergia e integruar për të kapitalizuar me kohë iniciativat e vazhdueshme dhe për të përsheptuar ndikimin në zhvillimin ekonomik të ndërmarrjeve, veçanërisht të NVM-me.

Vizioni

Megjithëse vërehet një vëmendje e shtuar në vitet e fundit (përmendim këtu PEF 2021-2023), sërish vizioni i qeverisë në mbështetjen e inovacionit perceptohet si i kufizuar dhe i përqendruar kryesisht në Teknologjinë e Informacionit duke mos mbajtur parasysh inovacionin që përfshin potencialet në sektorët strategjike të ekonomisë. Në këtë drejtim, nëse i referohemi Strategjisë së Inovacionit, Shkencës dhe Teknologjisë 2017-2022, aty thuhet se “fokusi qëndron në zhvillimin e kërkimit shkencor bazuar në modelin Triple Helix me Ministrinë e Shkencës dhe Rinisë si institucioni përgjegjës në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shkencës dhe Inovacionit”. Nga ana tjetër,

VKM nr.1 datë 10.01.2017 mbi Zbatimin e Planit të Aktiviteteve 2017-2021 “Mbështetja për zhvillimin e politikave të Inovacionit bazuar në modelin Triple-Helix” ka përcaktuar Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave si institucionin përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi. Përsa i përket sipërmarrjes, Ministria e Financave dhe Ekonomisë është përgjegjëse në nxitjen dhe promovimin e inovacionit së bashku me AIDA-n si agjenci në varësi të saj. AKSHI gjithashtu është përfshirë në kontekstin e inovacionit, si institucioni përgjegjës në zbatimin e

Figura 3. Vlerësoni angazhimin e institucioneve publike ndaj ofrimit të shërbimeve inovative.



Burimi: Pyetësori i Sekretariatit

60% e kompanive që iu përgjigjën pyetësorit nuk ishin në dijeni nëse qeveria e Shqipërisë ka një strategji mbi inovacionin dhe shkencën dhe 65% nuk ishin të qartë se cili është institucioni përgjegjës për të udhëhequr procesin e inovacionit në vend.


Figura 5. A e dini cili është institucioni përgjegjës në zhvillimin dhe mbështetjen e inovacionit në vend?

politikave për zhvillimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit³⁶.


Në lidhje me sa më sipër, kur kompanitë e anketuara u pyetën mbi informacionin që kishin mbi Strategjinë e Inovacionit si edhe për vlerësimin e angazhimit të institucioneve publike për ofrimin e shërbimeve inovative, 53% e tyre deklaruan se ka pak ose aspak angazhim.

³⁶ <https://akshi.gov.al/akshi/misioni/>

Figura 4. A e dini nëse ka një strategji për inovacionin në Shqipëri?



Burimi: Pyetësori i Sekretariatit



Burimi: Pyetësori i Sekretariatit

- Vërehet ndërgjegjësim nga ana e kompanive mbi masat dhe investimet e qeverisë për të dixhitalizuar shërbimet publike të ofruara për qytetarët dhe bizneset përmes platformave të centralizuara** (p.sh. e-Albania - e-tax, lejet elektronike, platforma e fiskalizimit) ose shërbimet online të ofruara nga noterët, QKB, shërbimet e transportit rrugor, etj. me qëllim ndikimin në uljen e burokracive, kohës së marrjes së shërbimit, por gjithashtu edhe rritjes së pritshmërive ndaj cilësisë së shërbime publike të ofruara. Në mënyrë të qartë masa të tilla u ndërmorën duke përdorur inovacionin dhe dixhitalizimin në kuadër të reformës së derregulimit, uljes së barrës administrative dhe lehtësimit të aksesit në shërbimet publike. Vlen të përmendet se rreth 240 institucione publike janë të lidhura në GOV.net dhe 600 shërbime ofrohen përmes platformës e-Albania³⁷.

- Mungesë e të dhënave të detajuara mbi inovacionin në sektorin publik dhe privat. Të pasurit e të dhënave të besueshme dhe në kohën e duhur është thelbësore për qeverinë që të zhvillojë politika të duhura në mbështetje të inovacionit, por edhe për biznesin pasi mundëson parashikime reale mbi aktivitetin ekonomik. Në Raport Progresin e BE-së (tetor 2020), thuhet se “Shqipëria duhet të bëjë përpjekje për të prodhuar statistika dhe të dhëna të besueshme për shkencën dhe teknologjinë, përfshirë treguesin e shpenzimeve të brendshme bruto për K&ZH, me synimin për të marrë pjesë në Indikatorin Evropian të Inovacionit.” Në këtë

³⁷ <https://akshi.gov.al/>

drejtim, vërehen objektiva dhe aktivitete të qarta të vendosura në Programin e Reformave Ekonomike 2021 - 2023, *por nevojitet një përshpejtim i këtyre aktiviteteve në kohë dhe targetim i qartë midis sektorëve për t'u përputhur më mirë me performancën dhe vlerësimin e të dhënave të vendit*³⁸.

Gjatë procesit tonë të konsultimit me biznesin, janë evidentuar shqetësime në lidhje me disponueshmërinë e të dhënave të detajuara sipas nënsektorëve ekonomikë, të ngritura kryesisht nga përfaqësues të modeleve të reja të biznesit (sektorë në zhvillim), të zhvilluara tashmë në Shqipëri si përgjigje ndaj depërimit të tregjeve të reja/globalizimit. Kjo mungesë e të dhënash ka krijuar problematika në përballjen e tyre me institucionet publike, për shembull kompanitë e tregtisë së internetit (*e-commerce*) u ankuan për mungesën e regjistrimit / klasifikimit të duhur të aktiviteteve të tyre ekonomike si shumë të rëndësishme për to për shkak të detyrimeve që lidhen me legjislacionin fiskal. Megjithatë ka disa përmirësime, i njëjti problem është sjellë edhe më parë (2017) në vëmendje nga sektori i BPO në Shqipëri.

- Nuk ka informacion të harmonizuar dhe të thjeshtë mbi aktorët kryesorë të ekosistemit të inovacionit. Ka shumë palë analoge që punojnë në fushën e inovacionit, prandaj identifikimi i duhur i tyre është i nevojshëm për të siguruar funksionalitetin e mirë të sistemit si i tërë dhe për të shmangur mbivendosjen.**

³⁸ Për shembull, publikimi i informacionit zyrtar mbi ndikimin e incentivave fiskale të ofruar ndaj sektorit TIK në vitin 2018, ose edhe ndaj sektorëve të tjerë.

Ka shumë iniciativa dhe projekte biznesi që janë në rritje, por ka mungesë të informacionit dhe koordinimit të strukturuar. Ekzistenca e tij është një parakusht që do të ndihmonte grupet e interesit (shoqatat, projektet, donatorët, etj.) të jenë më efikasë dhe të përqendruar për të mbështetur përpjekjet e inovacionit. Për shembull, janë krijuar qendra inovacioni në rajone të ndryshme në Shqipëri, por mungon informacioni dhe bashkëpunimi mes tyre. Mund të jetë e rëndësishme që këto qendra të përfshihen më shumë, dhe të sigurojnë mbështetje nga qeveria ose edhe projekte të ndryshme. Ka evidenca se me disa përjashtime si DHTI Tirana, akoma roli publik i shoqatave të biznesit mbetet i dobët në mbështetje të NVM-ve përsa i përket ekosistemit të inovacionit. Regjistrimi dhe certifikimi i startup-eve dhe lehtësuesve siç parashikohet në projektligj do të institucionalizojë dhe krijojë më shumë shanse për bashkëpunim të strukturuar dhe efektiv.

5. Kompanitë shqiptare dhe ekosistemi duhet të targetojnë inovacionin në produktet “Made in Albania”. Pavarësisht përparimit të dukshëm në iniciativat e biznesit për të futur produkte, teknologji (p.sh. robotikë në mermer, linja teknologjike të BE-së në prodhim, etj.) dhe shërbime që lidhen me inovacionin në tregun shqiptar, Shqipëria ende konsiderohet në nivelin e “software houses”. Kompanitë ndërkombëtare përdorin talentet kombëtare përmes eksportit të shërbimeve për krijimin dhe programimin e shërbimeve/produkteve të shitura kryesisht në tregjet ndërkombëtare. Evidentohet ekzistenca e potencialeve, siç është prodhimi i zgjidhjeve origji-

nale inovative për përdorim në tregun e brendshëm, por progresi dhe shpejtësia është i ngadaltë.


Sa më sipër, mund të lidhet me ekzistencën e forcave të dobëta të tregut për të nxitur ndërmarrjet e inovacionit që mbulojnë të gjitha fazat e tij: (a) inovacioni i produktit; (b) inovacioni i procesit; (c) inovacioni i marketingut dhe (d) inovacioni organizativ. Nga konsultimet u vërtetua se kjo mund të lidhet me arsyet e mëposhtme:

- » vështirësia e pronarëve të biznesit për të kuptuar dhe aspiruar inovacionin dhe teknologjitë e reja për shkak të mungesës së aftësive dixhitale dhe përshtatjes me trendet e reja;
- » mungesa e gatishmërisë së NVM-ve në veçanti, për të eksploruar modele të reja biznesi në një treg me sofistikim dhe zbatim të ulët të standardeve, informalitet të lartë dhe konkurrencë të ulët.

6. Pavarësisht disa iniciativave sporadike, modeli Triple Helix nuk është funksional si rezultat i mungesës së besimit midis universiteteve dhe sektorit privat, si dhe mungesës së rolit rregullator të qeverisë në këtë drejtim.

Pavarësisht disa projekteve që nga viti 2005, Shqipëria mbetet e kufizuar në dhënien e rezultateve reale në lidhje me mirë-funksionimin e modelit Triple-Helix. Konkretisht, duke iu referuar anketës së Sekretariatit dhe procesit të konsultimit, kompanitë e konsiderojnë rolin e akademisë në ekosistemin e inovacionit të biznesit si burim të fundit në marrjen e informacionit.


Figura 6. Gjatë 3 viteve të fundit, sa të rëndësishëm kanë qenë burimet e mëposhtme të informacionit në aktivitetet tuaja inovative? (vlerësoni nga 1 në 5 ku 1 = aspak dhe 5 = shumë e rëndësishme)



Burimi: Pyetësor i Sekretariatit

Konkretisht, vetëm 6,3% e kompanive i konsideruan universitetet si burim shumë të rëndësishëm në aktivitetet e tyre inovative. Nga ana tjetër, 63,4% e kompanive deklaruan se bashkëpunimi me akademinë është shumë i nevojshëm dhe i rëndësishëm në ofrimin e informacioneve mbi zhillimet e fundit të inovacionit.

Figura 7. A mendoni se një bashkëpunim me sektorin akademik është i domosdoshëm në sigurimin e informacionit mbi mundësitë që ofrojnë zhvillimet e fundit



Burimi: Pyetësor i Sekretariatit

Duke u mbështetur në rezultatet e mësipërme, si edhe duke përfshirë idetë e ndara gjatë procesit të konsultimit, evidentohet se bashkëpunimi merr forma të ndryshme midis aktorëve pub-

Burimi: Pyetësor i Sekretariatit

lik ose privat, ose shkencave të aplikuara dhe atyre shoqërore. Në përgjithësi, universitetet e shkencës së aplikuar dhe të bujqësisë perceptohen si më të përparuar në këtë drejtim.

Nga konsultimet, gjithashtu u vërejt një vullnet i veçantë për bashkëveprim midis universiteteve dhe sektorëve privatë apo edhe midis universiteteve të ndryshme. Pengesat kryesore për bashkëpunim lidhen me mungesën e infrastrukturës së duhur dhe të përshtatur me trendet e kohës si edhe mentalitetit të vjetër në krijimin e këtyre bashkëpunimeve.


2. BIZNESI KUNDREJT INOVACIONIT

1. Mentaliteti, mungesa e besimit, mungesa e njohurive dhe disponueshmëria e fond-eve perceptohen si pengesat kryesore të biznesit në përdorimin/prodhimin e inovacionit

Për t'u përfshirë në iniciativa inovative dhe për të krijuar ndryshime, pronarët/drejtnesit e biznesit duhet të kenë aspirata, të marrin në konsideratë rishpërndarjen e burimeve dhe zgjedhjet e portofolit të biznesit të tyre. Megjithatë janë forcat/presioni i tregut që udhëheq procesin e

inovacionit, pronarët/drejtuesit e biznesit duhet të ekspozohen dhe të angazhohen në mënyrë të vazhdueshme në aktivitete inovacioni. Në këtë drejtim, vërtetohet se mentaliteti/mungesa e besimit konsiderohet si një pengesë e fortë në


Figura 8. Cilat konsideroni 3 pengesat kryesore në përdorimin e shërbimeve/produkteve inovative në Shqipëri?



Burimi: Pyetësori i Sekretariatit

Për kompanitë e reja në treg (1-3 vjet) kostot e larta të inovacionit konsiderohen si arsyeja kryesore pse inovacioni është i vështirë për t'u përqa-

Figura 10. Cilat konsideroni se janë 3 pengesat kryesore në zhvillimin e produkteve/shërbime inovative nga kompanitë në Shqipëri?




Burimi: Pyetësori i Sekretariatit

përdorimin apo edhe në pranimin e inovacionit për kompanitë shqiptare.

Ndërsa, përsa i përket zhvillimit të ideve inovative, kostot e larta, mungesa e fondeve dhe mungesa e specialistëve konsiderohen si pengesa kryesore.

Figura 9. Cilat konsideroni 3 pengesat kryesore në zhvillimin e shërbimeve/produkteve innovative nga kompanitë në Shqipëri?




fuat, i ndjekur nga mentaliteti (19%) dhe mungesa e fondeve (19%). Vihet re se e njëjta panoramë është edhe për kompanitë e vjetra.

2. Ekosistemi i startup-eve është në fazë fillestare, përdorimi i teknologjive të reja dhe zgjidhjeve inovative nga ndërmarrjet është shumë i ulët, ndërsa alokimi i fondeve K&ZH është spontan dhe në pjesën më të madhe NVM-të nuk alokojnë fare buxhet³⁹.


³⁹ Ekosistemi i Sipërmarrjes në Shqipëri me fokus kryesor Tiranën, Projekti "EU for Innovation".

Figura 11. A e konsideroni inovacionin nxitës në ritjen e të ardhurave të kompanisë tuaj?



Burimi: Pyetësori i Sekretariatit


Figura 13. A keni zhvilluar aktivitete të K&ZH në 3 vitet e fundit?



Burimi: Pyetësori i Sekretariatit


Pothuajse të gjitha kompanitë e intervistuar e konsiderojnë inovacionin si një nxitës në ritjen e vlerës së tyre të tregut dhe aktiviteteve ekonomike (80,6%) dhe 72,6% e tyre deklarojnë se i kushtojnë vëmendje të lartë inovacionit në aktivitetin e tyre. Përkundër sa më sipër, kur u pyetën në lidhje me aktivitetet e K&ZH, vetëm 52% e kompanive deklaruan që kanë zhvilluar një aktivitet K&ZH me një buxhet rastësor. Vetëm 15% e kompanive kanë një fond të dedikuar K&ZH, ndërsa 75% e tyre alokojnë fonde në mënyrë rastësore.

Figura 12. Sa vëmendje i kushtohet inovacionit në kompaninë tuaj?



Burimi: Pyetësori i Sekretariatit

Figura 14. A ka kompania juaj fond të dedikuar për K&ZH?



Burimi: Pyetësori i Sekretariatit

Pra, biznesi është i ndërgjegjshëm që inovacioni shërben si një nxitës për të rritur performancën e kompanisë, por shumica e tyre, pavarësisht madhësisë, nuk ka një fond të dedikuar K&ZH. Mospërputhja midis konsideratës së bizneseve për inovacionin (*si një nxitës i rëndësishëm për rritjen e të ardhurave*) dhe praktikës së ulët të biznesit në përdorimin e zgjidhjeve inovative (*mentaliteti, tradita, treg i vogël dhe stimuj të ulët drejt inovacionit, alokimi i ulët i buxhetit*) materializohet edhe në raporte të ndryshme ndërkom-bëtare për Shqipërinë⁴⁰ sipas të cilëve biznesi shqiptar është pak konkurrues dhe ka produktivitet të ulët.

3. Shumica e kompanive konfirmojnë se nuk kanë një fond të dedikuar për trajnimin e stafit të tyre dhe se ekziston një hendek midis ofertës së studentëve dhe kërkesës që kompanitë kanë për fuqi punëtore.


Përsa i përket kapitalit njerëzor, evidentohet se punëtorët e kualifikuar mbeten një nga arsyet pse kompanitë e huaja zgjedhin Shqipërinë për të investuar. Sidoqoftë, shumica e kompanive të intervistuar, veçanërisht nga sektorët në zhvillim, konfirmuan se gjithsesi ata duhet t'i trajnonin studentët për t'u përshtatur me aftësitë e reja të kërkuara. Megjithatë ka shembuj të praktikës së mirë të bashkëpunimit të sektorit privat dhe universiteteve⁴¹, më shumë duhet bërë në lidhje me zhvillimin e trendeve të reja në sektorë të ndryshëm të ekonomisë.

Sipas biznesit, mospërputhja midis asaj që ofrojnë universitetet dhe asaj që kompanitë

kërkojnë lidhet kryesisht me bashkëpunimin e dobët biznes – sektori akademik, programet mësimore të vjetëruar dhe përshtatja e ulët e universiteteve me profesionet dhe aftësitë e reja të kërkuara nga tregu.


Gjithashtu, kompanitë nuk kanë një *fond të dedikuar* për të trajnuar punonjësit e tyre. 55% e kompanive deklarojnë se nuk kanë një fond të tillë, ndërsa 7% deklarojnë se dedikojnë fonde herë pas here. Vlen të përmendet gjithashtu se ekziston një konfirmim i gatishmërisë së fuqisë punëtore për të mësuar gjëra të reja. Për shembull, 68% e kompanive të përgjigjura deklarojnë se gatishmëria e punonjësve të tyre për të marrë aftësi të reja është shumë e lartë. 74% e kompanive kryejnë vlerësime për aftësitë e stafit të tyre dhe nevojat për trajnim, por vetëm 14% e tyre përdorin trajnime jashtë kompanisë. Riorganizimi është veprimi më i zakonshëm i ndërmarrë për të adresuar mungesën e aftësive të stafit ekzistues (27%).

Figura 15. A ka kompania juaj fond të dedikuar për stafit?




Burimi: Pyetësi i Sekretariatit

Figura 16. Si e vlerësoni dëshirën e stafit për të mësuar aftësi trajnimin e të reja?




Burimi: Pyetësi i Sekretariatit

Figura 17. A bën ndërmarrja juaj vlerësime periodike të stafit?



Burimi: Pyetësi i Sekretariatit

Figura 18. Çfarë veprimesh ndërmerr kompania juaj për të adresuar aftësitë dhe nevojat e trajnimit të stafit



Burimi: Pyetësi i Sekretariatit


4. Formalizimi dhe mirë-funksionimi i tregjeve si parakusht për të investuar në inovacion

Informaliteti konsiderohet të jetë një nga pengesat kryesore për inovacionin e sektorëve ekonomikë në vend. Që prej janari 2021, qeveria filloi të zbatojë “fiskalizimin” si një tërësi masash për të zvogëluar evazi-onin fiskal në transaksionet me dhe pa para në dorë. Kur bëhet fjalë për të luftuar informalitetin, kompanitë janë të gjitha të një mendje, por koha e zgjedhur për të zbatuar këtë sistem të ri i ndan disi. Rreth 51% e kompanive deklarojnë se nuk është momenti i duhur për të filluar zbatimin e fiskalizimit, duke argumentuar mungesën e infrastrukturës, koston e lartë të zbatimit dhe mungesën e trajnimeve, ndërsa 32% theksojnë se është momenti i duhur për të filluar zbatimin e sistemit të ri, kryesisht sepse informaliteti duhet të marrë fund.

40 Raporti i Konkurrueshmërisë, Progres Raporti i BE-së, etj.

41 Deloitte me Universitetin e Tiranës, Fakulteti Ekonomik

Figura 19. A mendoni se fiskalizimi po zbatohet në momentin e duhur?




Burimi: Pyetësori i Sekretariatit

46% e kompanive pretendojnë se nuk janë të përgatitur për të përdorur sistemin dhe vetëm 29% deklarojnë se janë plotësisht të përgatitur në përdorimin e këtij sistemi të ri dhe të përmirësuar.

5. Udhëheqja e inovacionit, qeveria apo sektori privat dhe përgjigja në kohë e shërbimeve online


Analizat e të dhënave të të anketuarve tregojnë se sektori privat është i bindur të jetë më inovativ sesa sektori publik. Biznesi e pranon rolin e institucioneve publike në zhvillimin e sistemeve dhe sigurimin e integritetit me e-Albania, por ngre shqetësimin se ende nuk ka një standard kombëtar për zhvillimin e integritetit ndërmjet sistemeve të ndryshme. Si rezultat, të dhënat kërkojnë ditë ose edhe javë për t'u sinkronizuar midis tyre, duke rezultuar në mungesë të cilësisë dhe efikasitetit.

Figura 20. A jeni të përgatitur për përdorimin e sistemit të ri?




Burimi: Pyetësori i Sekretariatit

Figura 21. A mendoni se qeveria është përpara biznesit në institucionet publike?



Burimi: Pyetësori i Sekretariatit

Figura 22. A i përdorni shërbimet inovative të ofruara nga ofrimin e shërbimeve inovative?



Burimi: Pyetësori i Sekretariatit

Në përgjithësi, ekziston një konsensus që ndërveprimi i ndërsjellë online midis agjencive shtetërore dhe bizneseve në kuadrin e zgjidhjeve dhe platformave elektronike zvogëlon përdorimin e burimeve të vlefshme (koha, burimet njerëzore), inspektimet dhe burokracitë, duke përmirësuar klimën e biznesit (p.sh. e-tax, e-Albania). Shumë kompani gjatë intervistave kërkuar intensifikimin e ndërveprimeve të tilla, madje edhe në sektorë jo-tradicionale, ku mbikëqyrja rregullatore është e një rëndësie të veçantë si në aspektin e tregtisë ashtu edhe të gjurmueshmërisë. Për shembull, në farmaceutikë, kompanitë private mbështesin zhvillimin e mbikëqyrjes online të sektorit përmes platformave të ndërveprimit me Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, si një mjet i ndikimit rregullator në sektor, por edhe si një mjet për modernizimin e sektorit përmes analizave të mëtejshme të të dhënave në dispozicion në kuadër të farmakovigjilencës.

3. BURIMET FINANCIARE NË MBËSHTETJE TË INOVACIONIT NË SHQIPËRI

1. Nivel i ulët i përthithjes së fondeve mbi inovacionin


Në Progres Raportin për Shqipërinë 2020, Komisioni Evropian shprehet se “Sa i përket programeve strukturore të BE-së, Shqipëria merr pjesë në Horizon 2020 si një vend kontribues. Megjithëse pjesëmarrja në Horizon 2020 është përmirësuar dhe vërehet një trend i mirë për vitin 2019, performanca e përgjithshme vazhdon të jetë e ulët. Shkalla e suksesit e propozimeve me pjesëmarrjen e partnerëve shqiptarë është 8,1% (me rritje nga 7,8% nga viti i kaluar) krahasuar me 15,6% që është niveli i suksesit i Horizon 2020. Pjesëmarrja e sektorit privat në këtë program vijon të jetë e ulët.”

2. Informacion i limituar mbi fondet në dispozicion për financimin e inovacionit

Megjithëse shumë iniciativa janë ndërmarrë në vend, Shqipëria mbetet e dobët në kapacitetet përthithëse. Bizneset pretendojnë se kjo lidhet me mungesën e një qasjeje koherente mbi ndërgjegjësimin/promovimin e fondeve në dispozicion të inovacionit, mungesën e fondit kombëtar të inovacionit, kompleksitetin e instrumenteve të tillë si engjëjt e biznesit, kapitalin e sipërmarrjes, vështirësitë në dokumentacionin aplikues në përputhje me rregulloret e fondeve COSME, mungesën e profesionistëve për të shkruar projekt-propozime të mira.

Kjo është në linjë edhe me gjetjet nga studimi ynë, ku të dhënat tregojnë se në përgjithësi kompanive u mungon informacioni për financimin përmes fondeve të mundshme mbi inovacionin.

Figura 23. A keni informacion mbi fondet e disponueshme për mbështetjen e inovacionit?



Jo, nuk kam informacion

Po, kam informacion

Burimi: Pyetësori i Sekretariatit


90% e të anketuarve deklaruan që nuk kanë informacion që ekzistojnë fonde me kushte lehtësuese në mbështetje të inovacionit, ndoshta kjo është edhe arsyeja pse 36% e tyre deklaruan se kanë përdorur burimet e tyre financiare për të financuar idetë inovatore.

3. Mungesa e informimit ndiqet edhe nga një mospërputhje mes kërkesës dhe ofertës së disponueshme për financimin e saj si p.sh. për bizneset start-up.

Startup-et kanë kosto fillestare të larta dhe shoqërohen me rreziqe të shtuara dhe shkallë të ulët të suksesit. Kjo i bën ato jo aq tërheqëse për bankat e nivelit të 2-të. Për më tepër, evidentuam që financimi nga AIDA kryesisht mbulon kostot e makinerive ose një pjesë të kredive apo skemave të garancisë përmes bankave, por përthithja mbetet ende e kufizuar.

4. Megjithëse investimet në kërkime shkencore, teknologji dhe inovacion parashikohet të shkojnë deri në 1% të PBB-së deri

Figura 24. Nëse do të kërkonit fonde për financimin për mbështetjen e inovacionit ku do drejtoheshit në fillim?



AIDA

Bankë

Donatorë

Fonde të kompanisë tuaj

Tjeter

Burimi: Pyetësori i Sekretariatit

në 2022, ka stimuj të kufizuar publik për të rritur përfshirjen e Universiteteve në K&ZH dhe gjithashtu mungon një specifikim i qartë në programin e reformës ekonomike ERP 2021-23 mbi mënyrën se si do të arrihet ky objektivi.

5. Gjatë konsultimeve të Sekretariatit, u theksua ekzistenca e disa instrumenteve të paintegruar nën një organizëm mirë-funksional dhe gjithashtu domosdoshmëria e krijimit të një fondi kombëtar ose rajonal të inovacionit, duke qënë se:

- » Ka përpjekje të vazhdueshme nga donatorët që mbështesin inovacionin në nivelin qendror dhe rajonal përmes ofrimit të fondëve në këtë drejtim. Megjithatë, dëshmohet koordinim i kufizuar, mungesë orientimi dhe sistemesh matje të ndikimit (apo kontrolli).
- » Burime financiare të kufizuara për universitetet, duke përfshirë mungesën e një fondi të dedikuar për mbështetjen e inovacionit: uni-

versitetet publike shpenzojnë fondin e tyre të inovacionit duke mbështetur titujt akademikë për stafin e tyre, konferenca, seminare por jo për mbështetjen e ideve të startup-eve.

- » Institucionet financiare bankare (e jo-bankare) nuk promovojnë fonde për investime në inovacion dhe nuk financojnë bizneset fillestare (start-up), pasi këto konsiderohen investime me rrezik të lartë.
- » Nevoja e një qasjeje të integruar për të mbuluar mungesën e kapaciteteve institucionale në përthithjen e fondeve (veçanërisht në shkrimin e projekt propozimeve të mira).

4. TË TJERA

1. Çështjet në lidhje me madhësinë e tregut të vendit, ndërgjegjësimin për zonat e lira ekonomike dhe potencialin e ri për operacionet e biznesit

- » *Vështirësitë për të gjetur investitorë seriozë të gatshëm për të investuar në tregun inovativ shqiptar.* Shqipëria konsiderohet si një vend me treg të kufizuar në lidhje me inovacionin në TIK. Për më tepër, integrimi i kufizuar rajonal, mungesa e një ekosistemi të konsoliduar në inovacion dhe mungesa e traditës ose shembuj të qëndrueshëm apo histori suksesi në produktet e inovacionit, e bën të vështirë tërheqjen e investitorëve/engjëjt e biznesit. Sipërmarrësit në TIK dhe bizneset fillestare innovative (start-up) bëjnë një dallim midis investitorëve të huaj dhe investitorëve vendas. Sipas tyre, ndërsa investitorët e huaj nuk tërhiqen nga tregu shqiptar kryesisht për shkak të mungesës së marketingut të ekosistemit shqiptar të inovacionit ose skepticizmit në lidhje me reputacionin e firmave të reja shqiptare, investitorët vendas e identifikojnë investimin në startup-et TIK si të rrezikshëm për shkak të riskut të lartë

të dështimit të modeleve të biznesit (të cilat bazohen në ide, pa siguri në zbatim). Sipas tyre, kjo lidhet edhe me kushtet e tregut dhe çështjet e mentalitetit siç u përmend më lart.

- » *Ndërgjegjësim i kufizuar në lidhje me ligjin e TEDA-ve dhe inovacionin.* Shumë biznese fillestare (startup-e)/kompani nuk kishin informacion mbi ligjin e TEDA-ve dhe dispozitave apo stimujve mbi krijimin e Zonave të Inovacionit në Qarqe (ZIQ). ZIQ mund të zhvillohen nga aktorë të ndryshëm të inovacionit, ku teknologjitë dhe trendet e reja mund të shërbejnë si shembuj për: (1) shtyrjen përpara të zhvillimit të sektorit përmes rritjes së ofertës dhe kërkesës; (2) rritja e ndërgjegjësimin për rëndësinë e inovacionit si për sektorin privat ashtu edhe për sektorin publik dhe (3) përqendrimi i objektivave të sektorit publik dhe privat drejt modeleve inovative të biznesit. Mungesa e Zonave të Inovacionit në Qarqe, konsiderohet një minus për promovimin e Shqipërisë tek investitorët e huaj (komuniteti i engjëjve të biznesit, ndërmarrjet e konsoliduara fillestare/startup-et dhe fondet ndërkombëtare).
- » Profesionistët shqiptarë që punojnë në distance (online) për kompanitë ndërkombëtare kryesisht në fushën e TIK, IT, BPO po shtohen gjithmonë e më shumë, veçanërisht pas COVID-19. Kriza pandemike tregoi që bizneset e përqendruara në kanale jotradicionale të tregtisë dhe operacionet e kontraktuara nga jashtë, përmirësuan në mënyrë të konsiderueshme qarkullimin e tyre. Shumë kompani kanë arritur të sigurojnë shërbime dhe mallra për klientët e tyre, duke përdorur mjete elektronike dhe aftësi dixhitale, ose duke përshtatur organizimin e tyre menaxherial përmes mënyrave inovative të punës në distancë.

2. Çështjet e biznesit në lidhje me maksimizimin e potencialeve për inovacion në BPO dhe Ekonominë Dixhitale në Shqipëri

- » Ekonomia dixhitale ose e internetit mbetet akoma një treg i paeksploruar, me lidhje të dobëta me prodhimet “Made in Albania” dhe incentiva të ulëta për përdoruesit. Kjo rrjedh si pasojë e shërbimeve të kufizuara të pagesave dhe platformave jo të lehta në përdorim të krijuara nga operatorët e tregtisë elektronike dhe bankat. Disa kompani pretendojnë se potencialet janë të kufizuara për shkak të interesit bankar pasiv për të bashkëpunuar me ta në krijimin e platformave të rëndësishme për aktivitetet e tregtisë elektronike. Kjo vjen për shkak të arsyeve të mëposhtme:
 - (a) për shkak të mungesës së besimit në platformën e propozuar të tregtisë elektronike të ndërveprimit me klientët në lidhje me sigurinë e të dhënave, ose
 - (b) mungesës së interesit tregtar në modelin e propozuar të biznesit nga operatorët e tregtisë elektronike.
- » Nga takimet me bizneset e tregtisë elektronike ata raportuan se 95% e produkteve dhe shërbimeve të ofruar përmes platformave të tyre në Shqipëri, nuk ishin produkte shqiptare. Sipas tyre kjo lidhet me mungesën e sofistikimit të produkteve të prodhuara në Shqipëri, certifikimin e cilësisë dhe aftësitë e ulëta të marketingut të prodhuesve. Për këtë qëllim, sipas tyre, produktet shqiptare (me disa përjashtime të segmenteve të tregut), janë pak konkurruese në tregjet e huaja. Për më tepër, sasitë e ulëta dhe skepticizmi i prodhuesve në tregtinë elektronike si një mjet i tregtisë për t'u zgjeruar në tregjet e huaja, nuk ka ndihmuar në krijimin e një

modeli biznesi për ndarjen e kostove dhe fitimeve ndërmjet prodhuesve dhe operatorëve të tregtisë elektronike.

- » Sipas bizneseve që operojnë në fushën e tregtisë elektronike, ka mungesë të ndërgjegjësimit për potencialet e tregtisë elektronike dhe vështirësi nga agjencitë publike për të kuptuar modelin e tyre të të operuarit. Disa çështje të ngritura kanë të bëjnë me vizitat e shpeshta fiskale/inspektimet tatimore dhe perceptimin e modelit të tyre si të rrezikshëm nga Sistemi i Riskut të Taksave, shpenzimet e pa zbritshme (p.sh. blerja e programeve kompjuterike të zbarkuar nga ndërmarrjet e huaja). Për më tepër, pranohet që sektori ka pasur një zhvillim informal duke marrë parasysh që në shumë raste bazohet në modelin e biznesit të parave në dorë dhe dorëzimit të pagesave joformale të shërbimeve. Ash-tu si në rastin e BPO-ve, segmenti i tregtisë elektronike nuk është i mirë identifikuar në statistikën e vendit për numrin e saj të operatorëve dhe ndikimin e saj real në ekonomi.
- » Pandemia e Covid-19, solli në vëmendjen e të gjithëve rëndësinë e dixhitalizimit, pagesave në internet dhe përparimit të mëtejshëm në blerjet dhe tregtinë elektronike (e-commerce). Kapërcimi i barrierave në tregtinë elektronike është thelbësor që Shqipëria të realizojë potencialin e saj të plotë të zhvillimit. Bazuar në Urdhrin e Kryeministrit, nr. 110, datë 10.9.2020, u krijua një Grup Ndërmnistror për të hartuar një Plan Veprimi 2021-2024 mbi reformat/aktivitetet kryesore që do të ndërmerren për zhvillimin e tregtisë elektronike në Shqipëri. Grupi Ndërmnistror u ndihmua nga ekspertët e Bankës Botërore në hartimin e këtij Plani të Veprimit. Plani i veprimit është nën konsultim me ministrinë e linjës.

Në fushën e startup-eve ka disa arritje thelbësore gjatë vitit 2020:

- (1) Tre programe të reja akseleratore për startup-et në Tiranë (Uplift Albania, Flexible Start-up, Women Founders) dhe një në Shkodër (Flexible Start-up Support Programme – Regional Edition).
- (2) Rënditja ndërkombëtare e ekosistemit shqiptar është përmirësuar: Sipas raportit të StartupBlink, Shqipëria lëvizi 13 vende më lart në renditje.
- (3) Mbi 150 startup-e shqiptare janë mbështetur në zhvillimin e kapaciteteve të tyre, lidhjet dhe rrjetëzimin me Shqipërinë dhe në nivel ndërkombëtar, si dhe mbështetjen financiare përmes BE-së për Fondin e Sfidës së Inovacionit.
- (4) Referenca Rajonale: mbështetja rajonale e ekosistemit e ofruar në Qytetin e Korçës (Ndërtimi i ICT Hub Korça), Programi Flexible Start-up në Shkodër (i cili do të shtrihet edhe në dy qytete të tjera të vendit)
- (5) Mbështetja për Ligjin e Startup-eve: Objektivi i Ligjit për Startup-et është krijimi i kushteve, masave dhe skemave më të

mira për të mbështetur zhvillimin e startup-eve dhe ekosistemit të sipërmarrjes, duke krijuar gjithashtu Start-up Albania, një agjenci e re qeveritare, e cila do të vlerësojë tregun/ekosistemin, do të propozojë skema mbështetëse dhe akte nënligjore dhe do të ndjekë aktivitetet për të siguruar arritjen e objektivave kryesorë.

- (6) Mbështetja për Programin e Sipërmarrjes në Zyrën e Kryeministrit. Aktualisht, programi është në fazën përfundimtare të hartimit.
- (7) Ndërgjegjësim mes palëve të interesuara (private dhe publike) mbi konceptin e ndërmarrjeve inovative dhe rëndësinë e tyre si një forcë shtytëse për zhvillimin ekonomik drejt një shoqërie të bazuar në dije.
- (8) Fondi i Sfidës i projektit “EU for Innovation” ka dhënë 23 grante fillestare dhe 4 grante për Organizata Mbështetëse të Inovacionit (OMIs) në thirrjen e parë dhe të dytë të nisur gjatë vitit 2019. Thirrja e 3-të filloi në vitin 2020 dhe aktualisht është në fazën përfundimtare të vlerësimit.

REKOMANDIME

1. QEVERISJA – KUADRI LIGJOR DHE RREGULLATOR

REKOMANDIM 1.

Fuqizimi i ekosistemit të inovacionit dhe lidhjet midis palëve të interesuara përmes një kornize gjithëpërfshirëse ligjore dhe rregullative që konsiston në:

- a) **Përsheptimi i miratimit të projektligjit "Për Mbrojtjen dhe Zhvillimin e Startup-eve Inovative" që mundëson:**
 - » një listë të konsoliduar të incentivave jodiskriminuese administrative dhe financiare në dispozicion të investitorëve të huaj dhe vendas si një parakusht për konkurrencën e ndershme.
 - » një regjim vetë-rregullues të qeverisjes së ekosistemit bazuar në struktura si p.sh. Bordi i Vlerësimit për startup-et inovative me anëtarë të shumicës nga sektori privat.
 - » një portal elektronik në internet, i hapur, transparent dhe lehtësisht i aksesueshëm për startup-et inovative.
 - » krijimin e një Fondi Kombëtar për Inovacionin që mbështet aksesin në kreditim për inkubatorët e certifikuar dhe startup-et inovativë përmes garancive për huatë bankare.

REKOMANDIM 2.

Konsolidimi dhe harmonizimi i iniciativave qeveritare në lidhje me transformimin dixhital, teknologjik dhe inovacionin nga një institucion kryesor përgjegjës për koordinimin e politikave sektoriale për të nxitur:

- a) **Kërkesën për zgjidhje inovative mbi problemet qeverisëse⁴²:**
 - » përmes mekanizmave të Prokurimit Para-Komercial/Inovacionit që i mundëson sektorit publik të blejë shërbime kërkimore dhe zhvillimore (K&ZH) për probleme praktike dhe/ose sektoriale. Ligji i miratuar së fundmi nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" miraton konceptin e partneritetit për inovacionin të prezantuar dhe miratuar më parë nga Direktivat e BE-së. Për më shumë informacion mbi modelet e suksesshme të prokurimit para-komercial në nivelin e BE-së, kliko [këtu](#).
 - » përmes mbështetjes së projekteve që mundësojnë zgjidhje të zgjuara (smart)

⁴² Fillimi i procesit të fiskalizimit nga qeveria është një shembull i iniciativave që nxisin anën e kërkesës për zgjidhje inovative duke nxitur tregun përmes qeverisë, për të adresuar informalitetin, menaxhimin e taksave, etj. Deri më sot, janë certifikuar 29 kompani për ofrimin e zgjidhjeve inovative në lidhje me procesin e fiskalizimit.

për shembull në menaxhimin e mbetjeve, ekonominë e gjelbër (përmes inovacionit në energji, përfshirë por pa u kufizuar në aktivitetet e mëposhtme ndriçimi LED, instalimi diellor, stacionet e karikimit të Automjeteve Elektrik (EV), njësitë inteligjente, drejtuesit e frekuencës së ndryshueshme dhe ndërtimin e analizave), industria e TIK⁴³ dhe projektet Agro⁴⁴ që krijojnë zgjerim të tregjeve lokale e ndërkombëtare si dhe vlerë të shtuar.

- » Zgjerimi i mëtejshëm i numrit dhe cilësisë së shërbimeve publike të dixhitalizuara përmes platformave qeveritare. (Për shembull, shkëmbimi në kohë reale i të dhënave midis institucioneve që u mundësojnë përdoruesve marrjen e shërbimit/informacionit në kohë reale.)
- » Forcimi i përdorimit të dokumenteve elektronike, nënshkrimeve elektronike dhe dixhitale në aktivitetet tregtare/administrative në përputhje me strategjinë për administrim pa letra, përfshirë agjencitë ekzekutive dhe sistemin gjyqësor.
- b) **Oftërtën për zgjidhje inovative nga bizneset⁴⁵:**
 - » përmes stimuljeve për rritjen e investimeve K&ZH dhe shpenzimeve të marketingut. Për shembull, Qeveria duhet të marrë në konsideratë kapacitetin e inovacionit të

firmave ekzistuese dhe nevojën e tyre për të përmirësuar prodhimin dhe proceset e tyre të biznesit si dhe portofolin e produkteve, p.sh. përmes fondit të garantimit që subvencionon 50% të kostove për kërkimin dhe zhvillimin dhe punën kërkimore me interes praktik.

- » përmes sigurimit të fondeve të dedikuara në formën e borxhit ose kapitalit, ose përmes përjashtimit nga rregullat e përgjithshme si në rastin e transferimit të teknologjisë.
- » mjete të tjera bashkëpunimi, p.sh. iniciativat e Inovacionit të Korporatave (Universitete- Biznes-Donatorë) që ulin kostot e inovacionit dhe ndajnë rreziket.

REKOMANDIM 3.

Promovimi tek investitorët seriozë të huaj dhe vendas i përfitimeve dhe mundësive që ofron Ligji nr. 9789, datë 19.07.2007 "Për Zonat e Zhvillimit Ekonomik Teknologjik" dhe përafrimi i tij me kërkesat e ekosistemit për krijimin e "Zonave të dedikuara të Inovacionit". Kjo e fundit shihet nga aktorët e ekosistemit si një mjet eficient për të tërhequr përsosmërinë e biznesit në fushën e inovacionit dhe teknologjisë së lartë, e cila mund të shërbejë më tej si një pikë referimi për zgjerimin e numrit të ndërmarrjeve të reja dhe bizneseve që mbështesin inovacionin dhe/ose prezantojnë teknologji të lartë. Për këtë qëllim, mund t'ia vlejë të eksplorohej mundësitë që rrjedhin nga Ligji 9789/2007 në mbështetjen e idesë së krijimit të zonave të dedikuara të inovacionit dhe/ose zgjerimit të bashkëpunimeve në formën e grupeve industriale rajonale si modele funksionale dhe të qëndrueshme.

⁴³ TIK ka potencialin të zhvillojë zgjidhje dhe shërbime të sofistikuar softuerike, për shkak të numrit në rritje të startup-eve, frymës sipërmarrëse dhe interesit në rritje të të rinjve në TIK.

⁴⁴ Mundëson që produktet ushqimore shqiptare të hyjnë në tregjet e përparuara si organike dhe me vlerë të shtuar më të lartë lokale, ndërsa prodhimi vendas kthehet në prodhim të teknologjisë së lartë dhe eko i qëndrueshëm.

⁴⁵ Si mundet Legjislacioni i BE-së të shtyjë/frenojë Inovacionin, Komisioni Evropian (2014)

REKOMANDIM 4.

Mbështetje e targetuar për procesin e ndërkombëtarizimit të ndërmarrjeve fillestare (startup) nga AIDA (ose institucioni i ngarkuar për inovacion) përfshirë ndihmën për çështjet ligjore, të organizimit dhe fiskale, si dhe çështjet e pasurive të patundshme dhe të kreditimit. Përveç kësaj, startup-ët inovativë mund të përfitojnë nga pjesëmarrja falas në panairë dhe evente ndërkombëtare, si dhe nga iniciativa ndërkombëtare që synojnë favorizimin e rrjetëzimit me investitorët e mundshëm.

2. BASHKËPUNIMI “QUADRUPLÉ HELIX” (QEVERI - UNIVERSITET – BIZNES – SHOQËRI CIVILE/MEDIA)

REKOMANDIM 5.

Përsheptimi i strukturimit të një arsimit modern dhe të përqendruar në industri që të ofrojë punë me cilësi dhe me aftësi të lartë, duke kontribuar kështu në një rritje më të madhe, të qëndrueshme dhe më të shpejtë të kompanive. Si një çështje e gjerë, ajo duhet të ndihmojë në lidhjen më të mirë të fakulteteve akademike, instrumenteve të shkencës dhe teknologjisë (p.sh. parqe, qendra shkencore, etj.), përmes bashkëpunimit të tyre me industrinë, pasi synon krijimin e një personeli shumë të aftë dhe zhvillimin e njohurive bazë të shoqërisë.

REKOMANDIM 6.

Strukturimi i marrëdhënies dhe formatit të bashkëpunimit Universitet - Biznes, nga institucioni përgjegjës siç identifikohet qartë në Strategjinë e Specializimit të Zgjuar që po hartohet. Disa forma të mundshme të bashkëpunimit janë (1) krijimi i një platforme online ku çështjet e biznesit mblidhen dhe ndahen me

universitetet bazuar në fushën e tyre të specializimit dhe bazuar në këto çështje orientohen temat e diplomimit/master ose doktoraturës bazuar në çështjet praktike/problemet/nevojat për të dhëna - ngritur nga sektori privat, (2) orë të hapura me biznesmenë inovatorë ish-studentë, të cilët kanë provuar të jenë të suksesshëm në jetën e tyre profesionale të ftohen nga universitetet për të ndarë përvojën, sfidat dhe suksesin e tyre në një diskutim të hapur me studentët, (3) përmirësimi i kurrikulës duke e adaptuar me aftësitë e kërkuara nga tregu duke filluar nga shkollat e mesme e në universitete duke zgjeruar aftësitë praktike së bashku me teorinë, (4) orientim i rregullt i studentëve drejt tregut të punës, përmes konsultave periodike me shoqatat e biznesit, (5) përsheptues për të përmirësuar projektet në inovacion.

REKOMANDIM 7.

Stimulimi i edukimit të NVM-ve përmes përdorimit të medias (vizuale/sociale) si një mjet i fuqishëm për të tërhequr vëmendjen e përdoruesit në temat përkatëse siç është inovacioni. Programet ekonomike të sponsorizuara nga qeveria mund të përdoren për të rritur ndërgjegjësimin e NVM-ve mbi inovacionin dhe rëndësinë e bashkëpunimit me akademinë si mënyra më e mirë për të ndikuar në të ardhmen e biznesit të tyre.

REKOMANDIM 8.

Nxitja e bashkëpunimit midis universiteteve duke krijuar një konsorcium të bazuar në fushat specifike të specializimit të universiteteve anëtare. Ky konsorcium i bazuar në disa ekspertiza, do të shërbejë si një qendër praktike trajnimi për ndërmarrjet dhe do të mundësojë qëndrueshmërinë e njohurive të transferuara

nga projektet që mbështesin inovacionin në sektorë të ndryshëm të ekonomisë.

Rekomandim 9: Strukturimi i lidhjeve mes akademisë/bizneseve dhe institucioneve financiare për të gjetur mënyra për të financuar idetë e studentëve për startup-et bazuar në nevojat e identifikuar të NVM-ve. Një shembull i agjentëve ndërmjetësues mund të jenë strukturat e Zhvillimit Ekonomik Lokal (p.sh. Auleda Vlorë ose Teuleda Shkodër) që mund të thjeshtojnë proceset e ndërmjetësimit dhe monitorimit/ndjekjes.

3. AKSESI NË FINANCIM**REKOMANDIM 9.**

Amplifikimi i aksesit të thjeshtuar në skemat e garantimit të kredisë ose burimeve të tjera të financimit të NVM-ve në nivel kombëtar/ndërkombëtar përmes: (1) krijimit të fondeve shtetërore/donatorëve të garantimit të kredive në bazë ndarje risku ose ngritja e skemave të subvencionimit të interesave, (2) Krijimi i Fondit të Përbashkët të Inovacionit Publik - Privat për të investuar në inovacion që mbulon të gjithë sektorët ekonomikë, (3) Promovimi i këtyre skemave përmes një platforme kombëtare të unifikuar për lehtësinë e përdoruesve.

REKOMANDIM 10.

Sigurimi i këshillimit, trajnimit, krijimit të rrjetëzimit dhe mbështetjes së bashkëpunimit për NVM-të e inovacionit dixhital që kërkojnë fonde dhe rritjen e ndërgjegjësimit mbi (1) dispozitat e Ligjit Nr. 66/2020 “Për Tregjet Financiare të Bazuara në Teknologji të Regjistruara të Shpërndarë” (*blockchain*) i cili mundëson përfshirje më të madhe të fondeve të mundshme nga FINTECH dhe përdorimi i teknologjisë DLT;

gjetja e burimeve financiare të huaja alternative dhe ulja e kostove të shërbimeve të pagesave, (2) Nxitja e opsioneve alternative të financimit si *Crowdfunding* si “praktikë e financimit të një projekti ose sipërmarrjeje duke mbledhur shumë të vogla të parave nga një numër i madh njerëzish (“turma”) zakonisht përmes internetit (platformave online). Platformat e financimit të turmës në modelet e tyre të ndryshme (të bazuara në donacione, në shpërblime, në kapital dhe në hua) janë një burim i ri i fuqishëm i financimit alternativ që u lejon startup-eve mbledhjen e fondeve pa kolateralin që u kërkohet nga bankat.

REKOMANDIM 11.

Pas miratimit të Ligjit “Për Mbrojtjen dhe Zhvillimin e Startup-ve”, **të ngrihet një rrjet investitorësh të engjëjve të biznesit dhe identifikimi i iniciativave të mundshme ligjore të cilat mund të lehtësojnë dhe mbështesin investimet e tyre në ide inovative.**

4. NXITJA E POTENCIALEVE TË EKONOMISË DIXHITALE DHE KRIJIMI I SINERGJIVE MIDIS PALËVE TË INTERESUARA

REKOMANDIM 12.

Mbështetja e ekonomisë dixhitale (ekonomia e internetit) duke vendosur masa ligjore dhe rregullatore që lehtësojnë të bërit biznes në platformat dixhitale dhe internet. Platformat online tashmë janë aktorë të rëndësishëm ekonomikë, duke ndërlidhur të gjitha palët dhe duke rritur efikasitetin, përmes inovacionit dhe zhvillimit të modeleve të reja të biznesit veçanërisht gjatë krizës së Covid-19. Masat ligjore dhe rregullatore duhet të përqendrohen *ndër të tjera* në (1) mbikëqyrjen e tregtisë elektronike përmes

një identifikimi të qartë të aktorëve të tregtisë elektronike, rolin e tyre, aktivitetin dhe ndikimin e përgjithshëm të ekonomisë dixhitale në ekonominë shqiptare; (2) përgatitjen e udhëzimeve të thjeshta për kompanitë e tregtisë elektronike në lidhje me kategorizimin e shërbimeve të tyre për qëllim të shpenzimeve të zbritshme (p.sh. blerja e programeve kompjuterike për shkarkim) si dhe si të komunikohet mbi operacionet tatimore dhe doganore. Masa të tilla janë mjete për të mbështetur formalizimin sistematik, pastrimin e kuadrit të tyre të operacioneve dhe për të ulur burokracinë dhe pasigurinë.

REKOMANDIM 13.

Miratimi i legjislacionit sekondar në lidhje me zbatimin e Ligjit nr. 55/2020, datë 30.04.2020 “Për Shërbimet e Pagesave” që u mundëson një grupi më të madh të institucioneve/agentëve të licencuar fillimin e pagesave elektronike. Ai do të mundësojë rritjen e konkurrencës dhe do ta bëjë tregun më fleksibël duke lehtësuar bashkëpunimin tregtar midis bankave dhe operatorëve të tregtisë elektronike në krijimin e platformave të tregtisë elektronike të lehta dhe të besueshme për përdoruesit.

REKOMANDIM 14.

Në mbështetje të tregtisë elektronike, Banka e Shqipërisë dhe bankat tregtare duhet të marrin në konsideratë forma alternative të kleringut për transfertat lokale në EUR, në mënyrë që të ulin kostot e larta të ngarkuara nga rrjeti bankar korrespondent, për shembull Sistemi i Kleringut ose Sistemi i Pagesave të menjëhershme në Euro. Një studim i fizibilitetit në lidhje me

vëllimin e transaksioneve lokale të euros midis klientëve në Shqipëri, mund të jetë i dobishëm për të kuptuar më mirë nevojat e tregut në lidhje me kostot e transaksioneve.

REKOMANDIM 15.


Nxitja e formalizimit duke kufizuar dhe dekurajuar pagesat e parave me lek në dorë (cash). Masa për t’u konsideruar janë: a) një kufizim më i lartë i transaksioneve me para, duke inkurajuar bizneset dhe qytetarët të përdorin sistemin zyrtar bankar ose pagesa alternative elektronike dhe b) zhvillimi i legjislacionit për të lehtësuar dhe zgjeruar sistemet e pagesave elektronike në një shkallë shumë më të madhe se aktualisht. Përgatitja e një plani veprimi për përmirësimin e përfshirjes financiare dhe uljen e kostove për qasjen në bankë, për të rritur përdorimin e kartave të kreditit/debitit dhe zgjerimin e depërimit/përdorimit të POS, p.sh. vendosja e një sistemi të përpunimit dhe pastrimit të kartave brenda vendit në bashkëpunimi me kompanitë e kartave (Visa/Master) mund të ulte kostot dhe të përmirësonte përdorimin e mjeteve të pagesave elektronike. Më shumë informacion mbi këtë temë është dhënë nga Sekretariati i KI në rekomandimin 9 të mbledhjes XIV- *Formalizimi në Turizëm*.





REKOMANDIM 16.

Nëse aprovohet ndonjë plan veprimi që adreson gjetjet e Raportit Diagnostikues të Bankës Botërore mbi Tregtinë Elektronike (Shtator 2020), ai duhet të botohet dhe shpërndahet publikisht si një mjet për të rritur ndërgjegjësimin mbi sfidat dhe mundësitë e tregtisë elektronike dhe për të monitoruar fazat e zbatimit.

SHTOJCË

Profili i kompanive që kanë plotësuar pyetësonin online





BIBLIOGRAFIA

1. ECD, 2005, "The Measurement of Scientific and Technological Activities: Guidelines for Collecting and Interpreting Innovation Data"
2. Strategjia Kombëtare e TIK, 2003-Ministria për Inovacionin dhe Teknologjinë e Komunikimit ERP 2021-2023
3. Anketa e Ndërmarrjeve në Shqipëri 2019, WB, EBRD, EIB,
4. Strategjia Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin 2017-2022
5. The Cross-Cutting Strategy on Information Society 2015 – 2020
6. Strategjia Kombëtare e TIK (2003)
 1. How Can EU Legislation Enable and/or Disable Innovation?, Komisioni i BE (2014)
 2. SME Policy Index: Western Balkans and Turkey 2019 Assessing the Implementation of the Small Business Act for Europe
7. <https://www.al.undp.org/content/albania/en/home/sustainable-development-goals/goal-9-industry-innovation-and-infrastructure.html>
8. Sustainable Development Goals and the environment in Europe: a cross-country analysis and 39 country profiles
9. Annual report on implementation of the multi annual action plan for a regional economic area in Western Balkans
10. Global Entrepreneurship Index 2020, Who will finance Innovation?
11. The Multi-annual Action Plan (MAP) for a Regional Economic Area (REA) in the Eastern Balkans Six (WB),
12. The Global Competitiveness Report 2019
13. Albania E-Commerce Diagnostic 2020, World Bank
14. Anketa e KI 'Impakti i Covid-19 mbi Biznesin', 2020
15. Ligji nr. 66/2020 "Për tregjet financiare të bazuara në teknologji të regjistruara të shpërndarë"
16. Ligji nr. 105/2017 datë 30.11.2017
17. VKM nr. 730, datë 12.12.2018.
18. VKM nr. 284 datë 01.04.2015
19. VKM nr. 710 datë 01.12.2017
20. VKM nr. 37 datë 27.01.2021
21. VKM nr. 943, datë 9.10.2013 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të shtetit për inovacionin dhe administratën publike"
22. VKM nr. 673, datë 22.11.2017 "Për Riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, Ndryshuar me Vendimin nr. 36, datë 24.1.2018, me Vendimin nr. 448, datë 26.7.2018, me Vendim nr. 872, datë 24.12.2019
23. Vendimi i KM nr. 607, datë 31.8.2016 "Për Themelimin, Përbërjen, Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit" (AKKSHI)
24. Ligji nr. 54/2015 'Për krijimin dhe funksionimin e zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik'
25. Urdhri nr. 1 datë 10.01.2017 i Kryeministrit për Miratimin e Planit të Veprimit 2017 - 2021 "Mbështetje për zhvillimin e politikave inovative të bazuara në "TRIPLE HELIX" Model"
26. Rregullorja për Funksionimin e TEDA të miratuar me Vendimin e KM nr. 106 datë 10.02.2016
27. Projektligji "Për Mbështetjen dhe Zhvillimin e Startup-eve Inovative" dhe Racionale
28. Ligji nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik"
29. www.tatime.gov.al
30. www.arsimi.gov.al
31. www.nasri.gov.al
32. www.akkshi.gov.al
33. www.financa.gov.al
34. https://www.wipo.int/edocs/pubdocs/en/wipo_pub_gii_2020/al.pdf
35. <https://tirana.tumo.al/program/>

RRETH KËSHILLIT TË INVESTIMEVE NË SHQIPËRI

Këshilli i Investimeve ka si qëllim rritjen e besimit të ndërsjellë midis biznesit dhe qeverisë duke kontribuar në institucionalizimin e dialogut mbi politikat në vend. Kontribuon në reformat kombëtare dhe procesin e tranzicionit ekonomik duke ndihmuar në përmirësimin e institucioneve, ligjeve dhe politikave që promovojnë mirëfunksionimin e tregut.

Dr. Diana Leka (Angoni)

Drejtoresh e Sekretariatit
lekad@investment.com.al

Elvis Zerva

Ekspert Ligjor dhe Rregullator
zervae@investment.com.al

Elida Fara

Eksperte Ekonomike
farae@investment.com.al

Xaira Shurdha

Eksperte për Monitorimin dhe Bashkëpunimin
shurdhax@investment.com.al

Elisa Lula

Oficere Administrative dhe Komunikimi
lulae@investment.com.al

Publikuar nga Sekretariati i Këshillit të Investimeve (SKI), Dëshmorët e Kombit, Tiranë, Shqipëri
info@investment.com.al / www.investment.com.al / SKI është përgjegjës për përmbajtjen e këtij publikimi.

 Albania Investment Council  ALInvestCouncil  Albania Investment Council